



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 7 gusht 2023
Nr. ref.:AGJ 2241/23

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI161/21

Parashtrues

Suzana Zogëjani-Sekiraqa

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit
të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 310/2020, të 28 prillit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Suzana Zogëjani-Sekiraqa, e cila momentalisht është në vuajtje të dënimit në Qendrën Korrektuese në Lipjan dhe të cilën para Gjykatës e përfaqëson Kosovare Kelmendi, avokate nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 310/2020] e 28 prillit 2021 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme). Përmes Aktgjykimit të kontestuar ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e saj për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 37/2019] të 24 janarit 2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) dhe Aktgjykimit [PAKR. nr. 133/2020] të 3 korrikut 2020 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtrueses së kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 gusht 2021, parashtruesja e kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), e cila në Gjykatë u regjistrua më 30 gusht 2021.
6. Më 1 shtator 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban, gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, (kryesuese), Safet Hoxha dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 8 shtator 2021, Gjykata e njoftoi përfaqësuesen e parashtrueses së kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 19 tetor 2021, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatë informata shtesë lidhur me rastin, duke (i) sqaruar pretendimet që i kishte paraqitur në kërkesën fillestare; si dhe (ii) dorëzuar dokumente (procesverbale të përpiluara nga autoritetet franceze dhe dokumente të tjera) të cilat gjithashtu janë dorëzuar në kërkesën fillestare.
9. Më 29 tetor 2021, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatë sërish informata shtesë lidhur me rastin.

10. Më 19 janar 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi propozimin e gjyqtarit raportues dhe vendosi që rasti të shqyrtohet në një seancë të ardhshme pasi të jenë bërë plotësime shtesë.
11. Më 15 shkurt 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi propozimin e gjyqtarit raportues dhe rekomandimit për shpalljen e kërkesës së parashtrueses si të papranueshme, por me shumicë vlerësoi se kërkesa është e pranueshme. Gjyqtari raportues në bazë të paragrafit (4) të rregullit 58 (Këshillimet dhe Votimi) të Rregullores së punës, kërkoi nga Kryetarja e Gjykatës që të caktohet një gjyqtar tjetër nga shumica, për të përgatitur draft-Aktgjykimin sipas propozimit të shumicës së gjyqtarëve. Në bazë të rregullit të lartcekur, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, si njërën nga anëtarët e Kolegjit shqyrtues, për të përgatitur draft-Aktgjykimin, sipas këshillimit dhe votimit të shumicës.
12. Më 10 mars 2022, parashtruesja e kërkesës sërish dorëzoi në Gjykatë informata shtesë lidhur me rastin.
13. Më 22 mars 2022, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e rastit dhe kërkoi nga e njëjta që të dorëzojë në Gjykatë dosjen e plotë të rastit.
14. Më 30 mars 2022, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të rastit.
15. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
16. Më 5 qershor 2023, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të informojë Gjykatën nëse parashtruesja e kërkesës, përveç kërkesës në Gjykatë, ka ushtruar ndonjë mjet tjetër të jashtëzakonshëm juridik në lidhje me Aktgjykimin e kontestuar.
17. Më 6 qershor 2023, Gjykata Themelore njoftoi Gjykatën se parashtruesja e kërkesës, më 4 prill 2023, ka ushtruar kërkesë për rishikimin e procedurës penale kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 37/19] të 24 janarit 2020 të Gjykatës Themelore.
18. Më 6 korrik 2023, gjyqtarja Selvete Gërxhaliu-Krasniqi prezantoi draft-Aktgjykimin para Gjykatës.
19. Të njëjtën ditë, Gjykata, me shumicë, vendosi: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) konstatoi se Aktgjykimi [Pml. nr. 310/2020] i 28 prillit 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës; Aktgjykimi [PAKR. nr. 133/2020] i 3 korrikut 2020 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [PKR. nr. 37/2019] të 24 janarit 2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, nuk janë në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 4 të nenit 31 të Kushtetutës dhe pikën (d) të paragrafit 3 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [Pml. nr. 310/2020] e 28 prillit 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës; Aktgjykimin [PAKR. nr. 133/2020] të 3 korrikut 2020 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [PKR. nr. 37/2019] të 24 janarit 2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; dhe (iv) të kthejë çështjen në rivendosje në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në përputhje me konstatimet e këtij Aktgjykimi.
20. Në përputhje me rregullin 61 (Mendimet mospajtuese) të Rregullores së punës të Gjykatës, gjyqtari Radomir Laban ka përgatitur mendim mospajtues, i cili do të publikohet së bashku me këtë Aktgjykim.

Përmbledhja e fakteve

21. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesja e kërkesës dhe i ndjeri A.S. ishin në marrëdhënie bashkëshortore që nga viti 2007.
22. Sipas shkresave të lëndës, më 20 tetor 2007, në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Prishtinë, bazuar në Sistemin e të Dhënave (në tekstin e mëtejme: SIPK) “*është iniciuar rasti me numër 2007-AC-1653 Dhunë Familjare*”, ku viktimë e dhunës në familje ishte parashtruesja e kërkesës. Më 1 nëntor 2007, parashtruesja e kërkesës kishte dorëzuar kallzim penal në Prokurorinë Themelore në Prishtinë kundër A.S-së.
23. Gjithashtu, sipas shkresave të lëndës rezulton se në vitin 2010, parashtruesja e kërkesës kishte shkuar për të jetuar në Republikën e Francës, dhe pas një kohe, atje kishte shkuar edhe bashkëshorti i saj, tani i ndjeri A.S. Duke iu referuar shkresave të lëndës, Gjykata vëren se më 2 dhjetor 2013; 16 dhjetor 2013; 24 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2013, respektivisht, parashtruesja e kërkesës u është drejtuar disa herë autoriteteve dhe organizatave të ndryshme franceze, duke raportuar “[...] *dhunë fizike, psiqike, ekonomike [...]*”, që bashkëshorti i saj, i ndjeri A.S., e ushtronte ndaj saj.
24. Po ashtu, sipas shkresave të lëndës, prej 16 dhjetorit 2013 deri më 31 mars 2014, parashtruesja e kërkesës ishte strehuar nga organizata joqeveritare “*Solidarité des Femmes*” të Besançonit në Francë, për shkak të raportimeve të vazhdueshme nga ana e parashtrueses së kërkesës për dhunë në familje si: “[...] *fyerje, kritika të vazhdueshme, kontroll dhe përcjellje të shpeshta, poshtërime, denigrime, kërcënime, marrjen e parave, shkatërrimin e orendive dhe të dokumenteve personale, rrahjes brutale, zvarritjen dhe shkuljen e flokëve, rrahje me shpulla dhe grushte [...]*”, ajo madje saktësoi se si: “*...fëmija i tyre, ishte dëshmitar i të gjitha këtyre dhunimeve*”.
25. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se më 30 korrik 2014, “*Shërbimi i Mbrojtjes Amëtare Foshnjore të Venissieux*” në raportin e përgatitur lidhur me rastin e parashtrueses së kërkesës, ndër të tjera, thekson se: “*zotëriu kishte filluar të ushtronte dhunë ndaj zonjës dhe X.X. Në suazën të specifikës sonë dhe ekspertizës lidhur me këto dukuri të dominimit në familje në veçanti me dhunimet bashkëshortore, situata e përshkruar në periudhën ku zonja ZOGJANI e martuar SEKIRAQA na dukej veçanërisht e shqetësuar sa i përket sigurisë saj dhe djalit të vet. Rifillimi i jetës së përbashkët bashkëshortore, duke iu përgjigjur një skeme karakteristike të situatave të dhunimeve bashkëshortore, na ka detyruar të alarmojmë shërbimet e mbrojtjes së fëmijës*”.
26. Më 26 qershor 2018, Gjykata e Apelit në Lyon nxori vendim kundër A. S., ndër të tjera, me arsyetimin: “*Sepse në Venissieux, më 13 maj 2018, në territorin kombëtar e gjatë gjithë kohës i pa mbuluar nga natë e ditë për pesë ditë ndaj bashkëshortes, duke ushtruar dhunë të qëllimshme dhe duke mos punuar punën e vet si duhet dhe të kujdeset për të dhe fëmijët dhe zonjës Suzana SEKIRAQA duke qenë bashkëshort i saj kryesisht duke e goditur, ka shkelur ligjin nga neni 22-13 alineja 1.6, neni 132-80 të kodit penal...*”. [Shënim i Gjykatës: ky citat është marrë nga përkthimi zyrtar i vendimit në gjuhën frenge i cili gjendet në shkresat e lëndës.]”.
27. Më 7 gusht 2018, pas denoncimit që kishte bërë parashtruesja e kërkesës kundër bashkëshortit të saj A. S., Gjykata e Lyonit e dënoi A. S.-në, me 3 muaj burgim, me dënim me kusht për 2 vite, si rezultat i dhunës familjare të ushtruar nga ky i fundit, ndaj parashtrueses së kërkesës.

28. Më 21 shtator 2018, rezulton se bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës, i ndjeri A. S., ishte privuar nga jeta. Të njëjtën ditë, parashtruesja e kërkesës së bashku me fëmijët e saj, ishte nisur nga Republika e Francës për në Republikën e Kosovës. Sipas raportit të përpiluar nga *“Direction Generale de la Police Nationale, Direction de Cooperation Internationale”* “i 2 Tetorit 2018 drejtuar Ambassade de France au Kosovo”, thuhet: [...] *“në fakt, elementet e para të hetuesisë na lejojnë të kuptojmë se bashkëshortja e të ndjerit bashkë me dy fëmijët kanë lëshuar me nxitim banimin familjar ndërmjet datës 20-21 shtator 2018. Data e ikjes apo nisjes së gruas përputhet me atë të vdekjes së burrit dhe konteksti familjar duket të jetë shumë i tensionuar, kjo na bënë të dyshojmë se gruaja mund të ketë pasur fuqishëm një rol aktiv në kryerjen e vrasjes”*.
29. Më 3 tetor 2018, është lëshuar raporti i autopsisë mjeko-ligjore, i cili përshkruan të gjitha specifikat mjeko-ligjore lidhur me ngjarjen që kishte ndodhur.
30. Më 4 tetor 2018, autoritetet franceze në ndjekje të parashtrueses së kërkesës kanë lëshuar dy urdhërarreste ndërkombëtare: (i) *“Mandat-Arresti Ndërkombëtar” ... meqë elementet faktike në procedurë mundësojnë të kuptojmë se Suzana ZOGEJANI në të kaluarën kishte qenë viktimë e dhunës fizike nga ana e bashkëshortit të saj...*; dhe (ii) *Mandat-Arrestin Evropian, sepse “Elementet faktike në procedurë paraqiteshin se Suzana ZOGEJANI në të kaluarën ishte dhunuar nga bashkëshorti i saj dhe se ajo tani dyshohet të ketë bërë veprën ose marrur pjesë në veprën [...]”*.
31. Po më 4 tetor 2018, rezulton se parashtruesja e kërkesës ishte paraqitur në Ambasadën e Republikës së Francës në Prishtinë dhe në të njëjtën ditë, ishte arrestuar nga autoritetet e Republikës së Kosovës.

Përmbledhja e fakteve që ndërlidhet me procesin penal ndaj parashtrueses së kërkesës

32. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ishte arrestuar nga autoritetet kosovare më 4 tetor 2018, nën dyshimin e bazuar se ka kryer veprën penale *“Vrasje e rëndë”* ndaj bashkëshortit të saj A.S.
33. Më 8 shkurt 2019, Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejshëm: Prokuroria Themelore), ngriti Aktakuzë (PP. nr. 261/18) kundër parashtrueses së kërkesës nën dyshimin e bazuar se ka kryer veprën penale *“Vrasje e rëndë”* nga neni 179, paragrafi 1 pika 1.3 dhe 1.4, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK).
34. Më 24 janar 2020, pas mbajtjes së disa seancave të shqyrtimeve gjyqësore, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore), nxori Aktgjykimin [PKR. nr. 37/19], përmes së cilit e shpalli parashtruesen e kërkesës fajtoreshë për kryerjen e veprës penale për të cilin ishte akuzuar, respektivisht për veprën penale *“Vrasje e rëndë”* ndaj bashkëshortit të saj A. S., nga neni 179, paragrafi 1 pika 1.3 dhe 1.4 të KPRK-së, duke i shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 25 (njëzet e pesë) vitesh, në të cilin është përfshirë edhe koha e kaluar në paraburgim prej 5 tetorit 2018 e tutje. Gjithashtu, parashtruesja e kërkesës përmes Aktgjykimit të lartpërmendur obligohet t'i paguajë edhe shpenzimet e procedurës penale.
35. Në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, ndër tjerash, theksohet se gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Themelore *“[...] ka proceduar dhe administruar të gjitha provat personale dhe materiale të propozuara nga palët në procedurë, dhe atë dëshmitarit-të dëmtuarit [H.S., E.H., A.S dhe X.X.]”, dëshmitarë të propozuar nga*

Prokuroria e Shtetit, si dhe janë proceduar dhe administruar prova të shumta, të cilat në arsyetim të Aktgjykimit të lartpërmendur janë përmendur në mënyrë taksative, siç janë leximi i dëshmimeve të disa dëshmitarëve [J.Ch., A.D., H.S., F.L., B.P. dhe L.S.] të pranuar nga autoritetet franceze, dëgjimi i disa dëshmitarëve gjatë shqyrtimit gjyqësor, leximi i procesverbaleve të përpiluara para autoriteteve franceze (marrë parasysh se vepra penale kishte ndodhur në Republikën e Francës ku edhe kishte jetuar parashtruesja e kërkesës me të ndjerin A.S.), raportin mjeko-ligjor të përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, si dhe certifikata e vdekjes e të ndjerit e lëshuar më 29 shtator 2018.

36. Më tutje, në arsyetim të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, ndër tjerash, theksohet se *"[...] bazuar në mënyrën e kryerjes së kësaj veprë penale nga e akuzuara Suzana Zogëjani-Sekiraqa, tek e njëjta ka ekzistuar dashja direkte dhe këmbëgulësia për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë, vrasje kjo e kryer në kuadër të dy rrethanave cilësuese, siç janë privimi nga jeta e anëtarit të familjes, në rastin konkret të bashkëshortit tani të ndjerë [A.S.] dhe vrasja në mënyrë dinake, ashtu që privimi nga jeta ka ndodhur derisa i ndjeri ishte duke fjetur [...]. Bazuar në një gjendje të tillë të fakteve, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha dëshmimeve dhe provave materiale të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, dëshmitë e dëshmitarëve dhe mbrojtjen kundërthënëse dhe të pabazuar të të akuzuarës Suzana Zogëjani-Sekiraqa, duke bërë një përmbledhje të të gjithë këtyre rrethanave të vërtetura gjatë shqyrtimit gjyqësor, pra se e akuzuara ka dalë shumë e relaksuar nga shtëpia bashkë me fëmijët e saj dhe ka udhëtuar me orë të tëra pa manifestuar ndonjë shqetësim për veprimet e saja [...]"*.
37. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën Themelore në Prishtinë, parashtruesja e kërkesës, ndër tjerash, kishte kërkuar që të bëhet ekzaminimi psikiatrik i saj lidhur me momentin e kryerjes së veprës penale, dhe në ndërlidhje me këtë, trupi gjykues i Gjykatës Themelore, kishte refuzuar këtë kërkesë specifike të parashtrueses së kërkesës. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu kishte pretenduar se dëshmitë e dëshmitarëve të cilat vetëm janë lexuar në shqyrtim gjyqësor, dhe të cilat parashtruesja e kërkesës nuk ka pasur mundësi që t'i ballafaqojë, janë lexuar në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe kishte kërkuar që të merren parasysh dëshmitë sipas të cilave do të vërtetohej që e njëjta kishte qenë viktimë e dhunës në familje. Mbrojtja e parashtrueses së kërkesës kërkoj që t'i lejohet ballafaqimi me dëshmitarët, dëshmitë e të cilëve vetëm janë lexuar në shqyrtim gjyqësor dhe që sipas parashtrueses së kërkesës tregonin në mënyrë jo të drejtë për karakterin e saj dhe raportet bashkëshortore në mes saj dhe bashkëshortit të saj.
38. Në ndërlidhje me kërkesën specifike të parashtrueses së kërkesës për ekzaminim psikiatrik, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Themelore, e cila kishte refuzuar kërkesën, duke theksuar se: *"Gjykata deri më tani nuk ka pasur para vetes asnjë provë bindëse së paku të besueshme, se e akuzuara ka manifestuar ndonjë sjellje që do e vënte në pikëpyetje aftësinë e veprimeve të saj, përkundrazi, veprimet e ndërmarra pikërisht vërtetojnë të kundërtën, pra veprimet e ndërmarra në natën kritike, dhe sjellja dhe aftësia e saj që të drejtoj veturën në një rrugëtim aq të gjatë pa asnjë problem apo ankesë, ta fsheh gjendjen emocionale eventuale për këto veprime nga fëmijët e saj të mos jetë në shkresat e lëndës asnjë raport mjekësor edhe për një vizitë paraprake rutinore psikiatrike, dhe edhe pas kësaj ngjarje të mos jetë vizituar nga ndonjë mjek psikiatër, të gjitha këto rrethana e përjashtojnë mundësinë absolute për ta vënë në pikëpyetje aftësinë e të kuptuarit të veprimeve të saj dhe dashjes direkte për shkaktimin e pasojës konkrete"*.

39. Më tej, Gjykata Themelore në Aktgjykimin e saj kishte theksuar se: “[...] edhe pretendimi i të akuzuarës Suzana se ka vepruar në gjendje të tronditjes së rëndë mendore, nga këndvështrimi tjetër, pra kinse abuzimi i të ndjerit [...], absolutisht nuk qëndron, pasi një gjendje e tillë e fakteve nuk është vërtetuar me asnjë provë personale e materiale, e ku edhe nga vet i mituri, i cili gjatë dhënies së dëshmisë së tij, ndër të tjera ka theksuar se ka qenë duke fjetur, nuk ka dëgjuar asgjë, për faktin se e ka gjumin e rëndë, përderisa vet e akuzuara rrëfen një skenar të një ngjarje të pa qenë kinse me abuzimin e të miturit, e që vërtetë edhe Hiqkoku do ia kishte zili të njëjtës për ndërtimin e një skenari të tillë imagjinar”.
40. Gjykata Themelore në arsyetim të Aktgjykimit gjithashtu theksoi se parashtruesja e kërkesës nuk ka vepruar në kushte të mbrojtjes së nevojshme, marrë parasysh rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, dhe se me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethana rënduese ka marrë parasysh rrethanat e kryerjes së veprës penale, këmbëngulësinë e parashtrueses së kërkesës për të kryer veprën penale, sjelljen e saj pas kryerjes së veprës penale. Lidhur me rrethanat lehtësuese, Gjykata Themelore në arsyetim të Aktgjykimit theksoi se “rrethana lehtësuese në rastin konkret nuk ka gjetur”.
41. Në një datë të paspecifikuar, Prokuroria Themelore parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, me propozimin që ky i fundit të ndryshohet dhe parashtrueses së kërkesës t’i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim se dënimi i shqiptuar.
42. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesja e kërkesës gjithashtu parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozimin që çështja të kthehet në rigjykim. Parashtruesja e kërkesës në ankesën e saj, ndër tjerash, (i) sërish kërkoi që t’i bëhet ekzaminimi psikiatrik për periudhën që kishte kryer veprën penale; (ii) sërish pretendoi se dëshmitë e dëshmitarëve të cilat vetëm janë lexuar në shqyrtimin gjyqësor dhe me të cilat parashtruesja e kërkesës nuk ka pasur mundësi që të ballafaqohet, si prova janë administruar në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës; dhe (iii) parashtruesja e kërkesës pretendoi, se dëshmitari X.X., përkatësisht i biri i saj, gjatë dhënies së dëshmisë së tij, ishte marrë në pyetje pa praninë e psikologut.
43. Më 29 prill 2020, Prokuroria e Apelit përmes parashtresës (PPA/I. nr. 140/20) propozoi që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë të aprovohet si e bazuar.
44. Më 3 korrik 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 133/2020] vendosi si në vijim:
- I. Aprovoi pjesërisht ankesën e parashtrueses së kërkesës përkitazi me kualifikimin e veprës penale, por edhe sipas detyrës zyrtare, duke ndryshuar Aktgjykimin [PKR. 37/2019] e Gjykatës Themelore të 24 janarit 2020, vetëm përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale, ashtu që, Gjykata e Apelit veprën penale për të cilën parashtruesja e kërkesës ishte shpallur fajtores, juridikisht e cilësoi si vepër penale “*urasje e rëndë*” nga neni 179, paragrafi 1, nënparagrafi 3 të KPRK-së, duke lënë në fuqi vendimin për dënim, përkatësisht Aktgjykimin [PKR. nr. 37/2019] të Gjykatës Themelore të 24 janarit 2020, përmes së cilit parashtruesja e kërkesës ishte dënuar me 25 vjet burgim;

- II. Ankesat e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, si dhe ankesat në baza tjera të parashtrueses së kërkesës, i refuzoi si të pabazuara dhe e vërtetoi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore.
45. Në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, ndër të tjera, shtohet se: *“Gjykata e shkallës së parë vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 361, par. 2 të KPPK-së, kurse për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 370, par. 7 të KPPK-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyes i merr si të provuara ose si të paprovuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore, pra ajo ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe ekspertizën mjeko-ligjore, pastaj deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor, e të cilat edhe ashtu nuk ndryshojnë në kuptim të vërtetimit të fakteve themelore, sidomos përkitazi me vërtetimin e fakteve dhe rrethanave se si erdhi deri tek privimi nga jeta i tani të ndjerit [A.S], fakte këto dhe rrethana që nuk i konteston as vet e akuzuara”.*
46. Si rrjedhojë, Gjykata e Apelit konsideroi se gjykata e shkallës së parë qasjen ndaj fakteve vendimtare e kishte të drejtë dhe të ligjshme. Gjykata e Apelit theksoi se gjykata e shkallës së parë ka pasur parasysh si dhe ka administruar një numër të madh provash, dhe prova materiale të propozuara nga parashtruesja për sigurimin e tyre nga shteti i Francës. Gjykata e Apelit më tej theksoi se Gjykata Themelore i ka marrë parasysh të dhënat përkitazi me të kaluarën e parashtrueses së kërkesës si dhe të të ndjerit A. S., nga të cilat rezulton se jo vetëm i ndjeri ka pasur sjellje të dhunshme, dhe këtë konstatim e bazon në dëshmitë e dëshmitarëve [J.Ch., A.D, H.S., F.L., B.P. dhe L.S.], të cilët dëshmitarë, përkundër kërkesës së vazhdueshme të parashtrueses së kërkesës për t'i ballafaquar të njëjtit, është refuzuar nga Gjykata e Apelit. Në ndërlidhje me atë që u tha më lart, Gjykata e Apelit më tej në Aktgjykimin e saj, duke iu referuar dëshmiave të dëshmitarëve të cilat vetëm janë lexuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe të cilat parashtruesja e kërkesës kishte kërkuar të ballafaqohet, theksoi se: *“[...] ngase edhe për të akuzuarën dëshmitarët në fjalë kanë vërtetuar sjelljet agresive të akuzuarës në raport me tani të ndjerin ka pasur sjellje të dhunshme, prandaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar propozimin për sigurimin edhe të provave tjera materiale nga Shteti i Francës, përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë”.*
47. Gjykata e Apelit tutje refuzimin Gjykatës Themelore për të kryer një ekzaminim psikiatrik të parashtrueses së kërkesës e mbështeti me arsyetimin si në vijim: *“[...] nuk rezulton se e njëjta ka qenë nën ndikimin e sjelljeve jo normale e që do të vinin në dyshim gjendjen e aftësisë mendore të akuzuarës, sidomos kur dihet se e njëjta, pasi që ka kryer veprën penale krejtësisht në mënyrë të qetë i merr fëmijët e saj dhe niset për në Kosovë”.*
48. Në vijim, pretendimin e parashtrueses së kërkesës se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore mbështetet në prova të papranueshme, duke iu referuar edhe dëshmisë së të miturit X.X., Gjykata e Apelit e refuzoi si të pabazuar, sepse sipas kësaj gjykate: *“[...] i njëjti ishte dëgjuar në prezencën e punëtorëve social të QPS-së [Qendrës për Punë Sociale] në Prishtinë”.*
49. Ndërsa, duke iu referuar provave të siguruara nga Republika e Francës, Gjykata e Apelit theksoi se të njëjtat janë proceduar në pajtim me dispozitat ligjore të Shtetit të Francës, duke shtuar se: *“[...] sipas dispozitave të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar të Kosovës, të gjitha provat që sigurohen nga shteti tjetër duhet të jenë procedura konform dispozitave të Ligjit të atij Shteti”.*

50. Më tutje, pretendimin e parashtrueses së kërkesës që ndërlidhet me shkeljen e ligjit penal sa i përket kualifikimit të veprës penale, Gjykata e Apelit e konsideroi të bazuar. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata e Apelit vlerësoi se: *"[...] në rastin konkret është shkelur Ligji Penal në dëm të akuzuarës, kur gjykata të akuzuarën e ka shpallur fajtores për veprën penale vrasje e rëndë nga neni 179, par. 1 nënpar. 3 e 4 të KPK-së, për formën cilësuese të veprës penale të paraparë sipas paragrafit 1 sipas paragrafi 1 nënpar. 4 të nenit 179 të KPK-së[...] veprimet inkriminuese të akuzuarës, të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, t'i cilësoj si vepër penale vrasje e rëndë nga paragrafi 179, par. 1 nënpar. 3 të KPK-së, për çka edhe vendosi që aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet ashtu që veprimet inkriminuese të akuzuarës, të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, t'i cilësoj si vepër penale nga neni 179, par. 1 nënpar. 3 të KPK-së, kjo për shkak se nënpar. 4 i dispozitës në fjalë, përfshin formën kualifikuese të veprës penale vrasje, kur vrasja kryhet me elemente të mizorisë dhe dinakrisë [...]"*.
51. Më 28 tetor 2020, parashtruesesja e kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, në Gjykatën Supreme kundër dy aktgjykimeve të lartcekura të shkallës më të ulët, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe shkelje të ligjit penal. Parashtruesja e kërkesës, ndër tjerash, pretendoi se:
- i) të dy aktgjykimet e shkallës më të ulët, janë marrë duke u bazuar në prova të papranueshme dhe specifikoi se ajo është shpallur fajtores duke u bazuar kryesisht në dëshmitë e disa dëshmitarëve të dhëna para autoriteteve franceze, të cilat janë lexuar në shqyrtimin gjyqësor dhe të cilat dëshmi në asnjë fazë të procedurës, as ajo dhe as mbrojtja e saj, nuk kishte mundësinë që t'i kundërshtonte, përkundër kërkesës së saj të vazhdueshme, dhe të cilat dëshmi sipas saj do e sqaronin faktin krucial se *"cili ishte sulmuesi apo agresori"*;
 - ii) rasti i saj para gjykatave të rregullta nuk është trajtuar si rast i dhunës në familje, sepse, sipas saj, kjo do të sqaronte gjendjen e afektit si pasojë e *"keqtrajtimit të vazhdueshëm të saj [...]"*;
 - iii) aktgjykimi i shkallës së parë gjithashtu është bazuar në prova të cilat, sipas saj, nuk i përmbushin standardet e përcaktuara me ligj për t'u konsideruar si prova;
 - iv) gjykatat e shkallës më të ulët nuk kanë dhënë arsye një nga një dhe në lidhshmëri me njëra-tjetrën për një mori provash materiale si e kaluara kriminale e të ndjerit, faktit se i ndjeri ishte lajmëruar nga parashtruesja e kërkesës për ushtrimin e dhunës në familje në Kosovë dhe gjatë qëndrimit në Republikën e Francës;
 - v) gjykata e shkallës së parë, gjatë marrjes së dëshmisë ndaj X.X. i cili ishte i mitur, kishte bërë shkelje të ligjit penal sepse gjatë marrjes së dëshmisë të të miturit nuk kishte marrë pjesë psikologu por vetëm punëtori social;
 - vi) shkelje të ligjit penal me rastin e refuzimit të kërkesës së saj për ekzaminim psikiatrik në kohën e kryerjes së veprës penale; dhe
 - vii) mosserioziteti i aktgjykimit të shkallës së dytë shprehet edhe në faktin se në faqen 3 të po këtij Aktgjykimi i referohen fakteve të një rasti tjetër.
52. Më 28 prill 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [PML. nr. 310/2020] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesja e kërkesës.
53. Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj, lidhur me pretendimet e parashtrueses së kërkesës, ndër tjerash, theksoi si në vijim:
- i) Lidhur me pretendimin e parashtrueses së kërkesës, se ajo ishte shpallur fajtores duke u bazuar kryesisht në dëshmitë e dëshmitarëve të marra në

Francë dhe të cilat ajo nuk ka pasur mundësi t'i kundërshtojë, Gjykata Supreme theksoi se duke pasur parasysh se vrasja është kryer në Francë, dhe marrë parasysh faktin se parashtruesja e kërkesës pas kryerjes së veprës penale kishte ardhur në Kosovë, ku edhe ishte arrestuar, është evidente se një mori provash janë marrë nga autoritetet franceze, në mesin e tyre edhe dëshmitë e disa dëshmitarëve të cilat vetëm janë lexuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, pa pasur mundësi që të njëjtat t'i ballafaqojë. Gjykata Supreme shtoi se këto prova, gjykata e shkallës më të ulët nuk i kishte konsideruar si kruciale, duke theksuar, se: *"[...] ngase nuk janë dëshmitarë okular të ngjarjes për të treguar se si është zhvilluar ngjarja kritike dhe as që gjykata i ka vlerësuar si prova të tilla"*;

- ii) Lidhur me pretendimin e parashtrueses se Aktgjykimi i shkallës së parë gjithashtu është bazuar në prova të cilat nuk i përmbushin standardet e përcaktuara me ligj për t'u konsideruar si prova të pranueshme, Gjykata Supreme, theksoi si, në vijim: *"[...] nga shkresat e lëndës rezulton se provat e siguruara nga autoritetet Franceze janë marrë konform dispozitave të procedurës penale të Francës, dhe si të tilla edhe i janë dorëzuar autoriteteve vendore. Në fakt, mbrojtësja vetëm citon dispozitat ligjore të kodit të procedurës penale (neni 219, par. 6 të KPPK-së) por nuk konkretizon faktin se në çka konsiston kundërligjshmëria e tyre"*;
- iii) Sa i përket pretendimit specifik të parashtrueses të kërkesës se gjykatat e rregullta nuk kanë dhënë arsye *"një nga një dhe në lidhshmëri me njëra-tjetrën"* për një mori provash materiale, si e kaluara kriminale e të ndjerit, faktit se i ndjeri ishte paraqitur për dhunë në familje edhe në Kosovë dhe në Francë, Gjykata Supreme theksoi se: *"[...] nga shkresat e lëndës del se i ndjeri ishte evidentuar nga organet e policisë si i dyshimtë për shumë vepra penale, por ky fakt është jo relevant në raport me veprën penale të kryer ndaj tij [...]"*;
- iv) Lidhur me pretendimin e parashtrueses se gjykata e shkallës së parë, gjatë marrjes së dëshmisë të të miturit X.X., kishte bërë shkelje të ligjit penal sepse gjatë marrjes së dëshmisë së tij nuk kishte marrë pjesë psikologu por vetëm punëtori social, Gjykata Supreme vlerësoi se në këtë rast nuk ishte shkelur neni 130, paragrafi 5 i Kodit të Procedurës Penale, pasi që kjo dispozitë thekson se gjatë marrjes në pyetje të personit i cili nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet, sidomos kur ai është i dëmtuar me veprën penale veprohet me kujdes. Nga kjo dispozitë, sipas Gjykatës Supreme: *"[...] del se marrja në pyetje përmes psikologut nuk është detyrim i gjykatës por në rast se gjykata e sheh të nevojshme, pra është në diskrecion të gjykatës [...] Në rastin konkret, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme, por X.X. është marrë në pyetje në prezencë të përfaqësuesit të punëtorit social"*;
- v) Në ndërlidhje me pretendimin e parashtrueses së kërkesës për shkelje të ligjit penal me rastin e refuzimit të kërkesës së saj për ekzaminim psikiatrik në kohën e kryerjes së veprës penale, Gjykata Supreme theksoi se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar kërkesën duke dhënë arsye të qarta për këtë refuzim. Më tutje, lidhur me këtë pretendim, Gjykata Supreme shtoi se asnjë provë nuk rezulton që e argumenton faktin se parashtruesja e kërkesës nuk kishte qenë e aftë të përgjigjet për veprimet e saj, në momentin e kryerjes së veprës penale; dhe

- vi) Në fund, lidhur me pretendimin se në faqen e tretë të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, kjo e fundit i referohet një rasti tjetër, Gjykata Supreme në arsyetim të Aktgjykimit të saj theksoi se: “[...] *kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me një lëshim teknik i cili është bërë gjatë ekspeditimit të aktgjykimit më saktësisht fotokopjimit, i cili aktgjykimin nuk e bën të pakuptueshëm [...]*”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

54. Parashtruesja e kërkesës pretendon që vendimet e kontestuara të gjykatave të rregullta janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
55. Së pari, parashtruesja e kërkesës thekson se deri tek shkelja e paragrafit 4 të nenit 31 të Kushtetutës ka ardhur si pasojë e shkeljeve të dispozitave të KPPK-së, respektivisht: (i) paragrafi 2 i nenit 7 (Detyrimi i përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve); (ii) paragrafi 2 i nenit 9 (Barazia e palëve); (iii) paragrafi 6 i nenit 219 (Marrja e provave gjatë hetimit); (iv) paragrafi 5 i nenit 130 (Kushtet e përgjithshme për marrjen në pyetje në procedurë paraprake, marrjen e deklaratës në procedurë paraprake ose mundësinë hetuese të veçantë); (v) paragrafi 2 dhe 3 i nenit 257 (Rregullat e përgjithshme për provat); dhe (vi) neni 262 (Provat për përcaktimin e fajësisë) i KPPK-së. Në esencë, sipas parashtrueses së kërkesës, fakti që e njëjta nuk ka pasur mundësi t'i kundërshtojë deklaratat e dëshmitarëve, përkatësisht të ballafaqojë dëshmitë përkatëse, ka rezultuar në shkeljen e paragrafit 4 të nenit 31 të Kushtetutës.
56. Në kërkesën e saj, parashtruesja e kërkesës thekson se gjatë shqyrtimit gjyqësor “[...] *nuk i është lejuar prezantimi i provave të prezentuara nga mbrojtja e saj, që kanë të bëjnë me lëndime të shumta trupore, në regjionin e qafës, fytyrës dhe duarëve që e njëjta i ka marrë natën kritike nga tani i ndjeri të prezentuara nga mbrojtja përmes fotografive të shumta që i janë prezentuar gjykatës por nuk janë vlerësuar fare nga gjykata por janë injoruar sikur ato të mos ekzistonin fare*”. Parashtruesja e kërkesës pretendon se janë injoruar edhe provat materiale të prezentuara nga mbrojtësja e parashtrueses së kërkesës.
57. Parashtruesja e kërkesës më tej pretendon se në asnjë instancë gjyqësore nuk janë pranuar që të admistrohen prova, të cilat sipas saj do të shkonin në favor të mbrojtjes, “[...] *lidhur me dhunën permanente që viktimat ka ushtruar ndaj paraqitësve të kërkesës, për çka është dënuar me burg nga autoritetet gjyqësore të Francës*”.
58. Më tej, parashtruesja e kërkesës thekson se është shkelur paragrafi 4 i nenit 31 të Kushtetutës si rezultat i pamundësisë së saj që t'i marrë në pyetje dëshmitarët dhe ekspertët, dëshmitë e të cilëve vetëm janë lexuar në shqyrtim gjyqësor dhe të cilat ajo nuk ka pasur mundësi t'i ballafaqojë edhe përkundër kërkesave të saj të vazhdueshme, të cilët përmes dëshmisë së tyre kanë ndikuar që ajo të shpallet fajtores dhe të dënohet me njëzet e pesë (25) vite burgim.
59. Më tej, parashtruesja e kërkesës pretendon se pa një justifikim të arsyeshëm dhe përkundër kërkesës së saj në të gjitha instancat gjyqësore, është refuzuar edhe kërkesa për ekzaminim psikiatrik, i cili ekzaminim sipas saj do të vërtetonte gjendjen e saj mendore në momentin e kryerjes së veprës penale, duke shtuar se në momentin e kryerjes së veprës penale e njëjta ka qenë viktimë e dhunës në familje pikërisht nga i ndjeri A.S.

60. Parashtruesja e kërkesës shton se gjatë marrjes në pyetje në procedurë para Gjykatës Themelore, në cilësi të dëshmitarit okular X.X., i cili kishte qenë i mitur, ky i fundit dëshminë e tij e ka dhënë vetëm para punëtorit social e jo edhe para psikologut.
61. Parashtruesja e kërkesës pretendon se aktgjykimet e të gjitha instancave gjyqësore janë bazuar në prova të papranueshme, duke shtuar se: “[...] gjykatat e kanë shpërfillë detyrimin ligjor nga neni 290 par 6 i KPP-së, sipas të cilës dispozitë është parashikuar se provat e siguruara përmes rrugëve joformale nga qeveritë e shteteve të huaja, siç ka ndodhur rasti i sigurimit të dëshmitëve dhe provave të tjera materiale, raportet e këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe raportet e ekzaminimit mjeko-ligjor, të dërguara nga Franca, janë prova të papranueshme, nëse atyre provave nuk u është bashkëngjitur Deklarata e qeverisë franceze apo autoriteteve për zbatim të ligjit se ato dëshmi janë siguruar dhe janë marrë në përputhje me ligjin e atij shteti”.
62. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që të pranojë kërkesën si të pranueshme dhe të anulohen aktgjykimet e gjykatave të rregullta, në mënyrë që të “krijohen kushte për gjykim të drejtë dhe të paanshëm”.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 22

[Zbatimi i Drejtëpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtëpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

(7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;

Amandamenti nr. 26 [i miratuar nga Kuvendi I Republikës së Kosovës më 25 shtator 2020, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 30 shtator 2020];

Në nenin 22, pas paragrafit (8) shtohet paragrafi (9) si në vijim:

(9) Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

Neni 50

[Të Drejtat e Fëmijës]

1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre.

[...]

3. Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.

4. Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.

5. Secili fëmijë gëzon të drejtën për raporte të rregullta personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit e vet, me përjashtim kur institucioni kompetent përcakton se një gjë e tillë është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje [e miratuar më 7 prill 2011 nga Këshilli i Evropës si dhe e përfshirë në listën e Konventave dhe instrumenteve ndërkombëtare ligjore në nenin 22 të Kushtetutës përmes Amendamentit nr. 26, të 28 shtatorit 2020]

Kapitulli I

Qëllimet, përkufizimet, barazia dhe mosdiskriminimi, detyrime të përgjithëshme

Neni 3 Përkufizimet

(b) *“Dhunë në familje” nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njetën banesë me viktimën,*

Kapitulli IV Mbrojtja dhe mbështetja

Neni 18 Detyrimet e përgjithshme

[...]

3 Palët garantojnë që masat e marra sipas këtij kapitulli: – të bazohen në një perceptim gjinor të dhunës kundër grave dhe dhunës në familje dhe të fokusohen tek të drejtat e njeriut dhe siguria e viktimës; – të bazohen në një përqasje të integruar, e cila merr parasysh marrëdhënien midis viktimave, autorëve të veprave penale, fëmijëve dhe mjedisit të tyre më të gjerë social; – të synojnë shmangien e viktimizimit dytësor; – të synojnë fuqizimin dhe pavarësinë ekonomike të grave, viktimat të dhunës; – të lejojnë, sipas rastit, një gamë mbrojtjeje dhe shërbimesh mbështetëse që duhet të vendosen në të njëjtat ambiente; – të trajtojnë nevojat specifike të personave të pambrojtur, duke përfshirë viktimat fëmijë dhe t'u vihen në dispozicion.

4 Sigurimi i shërbimeve nuk varet nga gatishmëria e viktimës për të ngritur akuza ose për të dëshmuar kundër një autori vepre penale.

5 Palët marrin masat e duhura për të ofruar mbrojtje konsullore dhe mbrojtje dhe mbështetje tjetër për shtetasit e tyre dhe viktimat të tjera që kanë të drejtën e kësaj mbrojtjeje, në përputhje me detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare.

KONVENTA PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

Neni 3

1. Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të mirëqenies shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore.

2. Shtetet palë angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjorisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ato marrin të gjitha masat legjislative dhe administrative përkatëse.

3. Shtetet palë sigurojnë që institucionet, shërbimet dhe qendrat përgjegjëse për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe të aftësive të personelit të tyre si dhe të mbikëqyrjes së duhur.

LIGJI NR. 02/L-17 PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE

Neni 7 Roli i Qendrës për Punë Sociale

[...]

7.1. Secila komunë themelon një Qendër për Punë Sociale si institucion publik që do të ketë një ose më shumë degë (në tekstin e mëposhtëm: QPS) dhe personel të përbërë nga profesionistët me trajnime dhe kualifikime përkatëse - nëpunës të shërbimeve sociale sipas pikës 1.3 i. të këtij ligji. QPS është përgjegjëse për ushtrimin e kompetencave që ia jep ky ligj në emër të Ministrisë si dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në emër të Ministrisë. 7.2. Qendra për punë sociale formon organin e kujdestarisë dhe kryen detyrat që kërkohen për këtë funksion siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Kosovës.

[...]

Neni 9 Shërbimet për Fëmijë dhe Familje

9.1. Në të gjitha çështjet lidhur me ofrimin e shërbimeve për fëmijë dhe familje, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata e parë dhe më e rëndësishme.

9.3. Qendra për punë sociale ofron përkujdesje sociale dhe/ose këshillim në rrethanat kur një fëmijë është në nevojë për shërbime sociale dhe familjare sepse:

a. ai ose ajo është pa përkujdesje prindore;

b

g. ai ose ajo janë duke vuajtur si pasojë e konfliktit familjar;

KODI 04/L-082 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 179 Vrasja e rëndë

1. Me dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dënohet personi i cili:

[...]

1.3. privon nga jeta anëtarin e familjes;

1.4. privon nga jeta personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake;

[...]

KODI NR. 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE

Neni 7 Detyrimi i përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve

[...]

2. Sipas dispozitave të parapara me këtë Kod, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet

kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij, dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t'i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit.

Neni 9 Barazia e palëve

[...]

2. I pandehuri ka të drejtë të deklarohet dhe atij duhet t'i lejohet deklarimi për të gjitha faktet dhe provat që e ngarkojnë dhe t'i paraqesë të gjitha faktet dhe provat që janë në favor të tij. Ai ka të drejtë që të kërkojë nga prokurori i shtetit të thërret dëshmitarë në emër të tij. Ai ka të drejtë t'i marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta që vlejnë për dëshmitarët kundër tij.

Neni 130 Kushtet e përgjithshme për marrjen në pyetje në procedurë paraprake, marrjen e deklaratës në procedurë paraprake ose mundësinë hetuese të veçantë

[...]

5. Me rastin e marrjes në pyetje të personit i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, sidomos kur ai është dëmtuar me veprën penale veprohet me kujdes që pyetja të mos ndikojë dëmshëm në gjendjen e tij mendore. Kur është e nevojshme, ai pyetet me ndihmën e psikologut për fëmijë ose pedagogut për fëmijë apo ekspertit tjetër profesional.

Neni 219 Kërkesat ndërkombëtare

[...]

6. Provat e siguruara përmes rrugëve joformale nga qeveritë e huaja, organet për zbatimin e ligjit, prokuroritë apo gjykatat janë të pranueshme nëse atyre provave u bashkëngjitet deklarata nga qeveritë e huaja, organet për zbatimin e ligjit, prokuroria apo gjykatat që tregojnë se provat janë të bazuara dhe janë marrë në pajtim me ligjin e atij shtetit të huaj. Provat e tilla nuk mund të jenë bazë e vetme apo vendimtare për gjetjen e fajësisë. Të dhënat e tilla në shqyrtim gjyqësor shoqërohen me mbështetje të pohimit nga neni 263 i këtij Kodi.

Neni 257 Rregullat e përgjithshme për prova

1. Rregullat e provës të parapara në këtë nen zbatohen në të gjitha procedurat penale para gjykatës dhe, në rastet kur e parasheh ky Kod, ato gjithashtu zbatohen në procedurat para prokurorit të shtetit dhe policisë.

2. Provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu.

3. Gjykata nuk mund ta mbështesë vendimin e saj në prova të papranueshme.

Neni 262
Provat për përcaktimin e fajësisë

1. Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.
2. Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaramit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit.
3. Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin.
4. Gjykata nuk e shpall personin fajtor vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.

Neni 508
Zbatimi i ekzaminimit psikiatrik

1. Në çdo kohë gjatë procedurës, duke përfshirë kohën gjatë shqyrtimit gjyqësor, nëse ekziston dyshimi se i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale apo nëse ka ndonjë çrregullim mendor, gjykata sipas detyrës zyrtare ose me propozimin e prokurorit të shtetit apo të mbrojtësit, mund të caktojë ekspert sipas nenit 146 të këtij Kodi për të kryer ekzaminimin psikiatrik të të pandehurit për të konstatuar nëse:
 - 1.1. në kohën e kryerjes së veprës penale i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë së zvogëluar mendore; ose
 - 1.2. i pandehuri është i paaftë për të përballuar gjykimin.[...]

LIGJI NR. 03/L-182 PËR MBROJTJEN KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE
[i shpallur në Gazetën Zyrtare më 10 gusht 2010]

Neni 1
Qëllimi i ligjit

1. Ky ligj ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë viktime të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.
2. Ky ligj, po ashtu, ka për qëllim edhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave.

Neni 2
Përkufizimet

1.2. Dhunë në familje - një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në:

[...]

1.5. Kryerësi i dhunës në familje - personi, i cili ka kryer një apo me tepër vepra të dhunës në familje, kundër të cilit kërkohet urdhri për mbrojtje, urdhri për mbrojtje emergjente, ose urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente.

1.6. Viktimë - personi i cili i është nënshtruar dhunës në familje.

Neni 4

Masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial

1. Masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial, mund t'i shqiptohet kryesit të dhunës në familje në kombinim me ndonjë masë tjetër parandaluese, me qëllim të evitimit të sjelljeve të dhunshme të kryerësit apo nëse ekziston rrezik i përsëritjes së dhunës në familje.

2. Masa nga paragrafi 1 i këtij neni, zgjatë derisa të përfundojnë shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar, por nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtë muaj.

LIGJI NR. 04/L-213 PËR BASHKËPUNIM JURIDIK NDËRKOMBËTAR NË ÇËSHTJET PENALE

KREU VI

NDIHMJA JURIDIKE E NDËRSJELLË

Neni 80

Parimet

1. Me kërkesën e organit gjyqësor të shtetit tjetër organet gjyqësore vendore ofrojnë ndihmë në lidhje me procedurat penale për vepra penale ndjekja e të cilave në kohën e kërkesës për ndihmë bie brenda juridiksionit të organeve gjyqësore të shtetit kërkuar.

2. Ndhmë juridike brenda kuptimit të paragrafit 1 të këtij neni do të jetë çdo lloj i ndihmës së dhënë për organet e huaja, pavarësisht nëse procedurat penale të huaja zhvillohen nga gjykata apo prokuroria, apo nëse ndihma juridike duhet të ofrohet nga një gjykatë apo prokurori.

3. Ndhma juridike nën këtë Kapitull mund të kërkohet dhe ofrohet edhe lidhur me marrjen e masave të përkohshme me qëllim të ruajtjes së dëshmisë, ruajtjes së një situatë ekzistuese apo mbrojtjes së interesave juridike të rrezikuara.

4. Organet gjyqësore vendore i japin përparësi ekzekutimit të kërkesave për ndihmë juridike të ndërsjellë dhe marrin në konsideratë afatet procedurale dhe kushtet tjera të përmendura shprehimisht nga shteti kërkuar.

KËRKESAT VENDORE PËR NDIHMË JURIDIKE TË NDËRSJELLË TË DREJTUAR SHTETIT TJETËR

Neni 82

Autoriteti që parashtron kërkesë për ndihmë juridike

1. Gjatë procedurës paraprake deri në ngritjen e aktakuzës, kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë paraqitet nga prokurori i shtetit i cili udhëheq procedurën për të cilën kërkohet ndihmë. Në rastet kur veprimi apo masa që kërkohet të ndërmerret po të ishte ndërmarrë në Republikën e Kosovës në bazë të Kodit të

Procedurës Penale do të kërkonte një urdhër nga gjykata, atëherë kërkesa duhet të parashtrahet nga gjykata në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit.

2. Pas ngritjes së aktakuzës, kërkesa për ndihmë juridike duhet të paraqitet nga gjykata që zhvillon procedurën për të cilën kërkohet ndihmë.

3. Kërkesa për ndihmë juridike i dorëzohet Ministrisë e cila e shqyrton dhe transmeton atë së bashku me çdo dokument tjetër mbështetës tek autoriteti kompetent i shtetit të kërkuar.

Neni 83 **Përmbajtja e Kërkesës**

1. Kërkesa për ndihmë bëhet me shkrim dhe përfshin informatat e mëposhtme:

1.1. emrin e organit që zhvillon procedurën penale lidhur me të cilën bëhet kërkesa;

1.2. përshkrimin e fakteve të çështjes, kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale dhe çdo dëm të shkaktuar, si dhe emërtimin ligjor të veprës penale;

1.3. ekstraktin e dispozitave ligjore të zbatueshme, duke përfshirë dispozitat për parashkrimin dhe dënimin që mund të shqiptohet;

1.4. identitetin e personave kundër të cilëve zhvillohet procedura penale për të cilën kërkohet ndihma; 1.5. përshkrimin e veprimeve të kërkuara dhe shpjegimin se si lidhen ato me faktet e rastit; 1.6. kur është e nevojshme, të dhëna rreth afatit kohor brenda të cilit duhet të ekzekutohet kërkesa dhe arsyetimin e urgjencës;

1.7. kur është e nevojshme, identifikimin e personave që do të autorizohen të jenë të pranishëm gjatë ekzekutimit të kërkesës;

1.8. kur është e nevojshme, informata mbi kompensimin që i takon personit që ftohet për tu paraqitur me qëllim të dhënies së dëshmisë;

1.9. kur është e nevojshme, të dhënat teknike të nevojshme për marrjen e dëshmiave përmes video-konferencës.

2. Kërkesa për ndihmë, për aq sa është e nevojshme dhe e mundur, gjithashtu do të përfshijë:

2.1. informata mbi identitetin e personit subjekt i kërkesës dhe vendndodhjen e tij apo saj;

2.2. informata mbi identitetin dhe vendbanimin e personit ku duhet të shërbehen dokumentet dhe statusin e tij apo saj në procedurë, si dhe mënyrën në të cilën duhet të bëhet shërbimi;

2.3. informata mbi identitetin dhe vendbanimin e personit që duhet të jap dëshmi apo të bëjë deklaratë;

2.4. vendndodhjen dhe përshkrimin e vendit apo sendit që do të inspektohet apo ekzaminohet;

2.5. vendndodhjen dhe përshkrimin e vendit që duhet kontrolluar dhe evidentimin e sendeve që duhet sekuestruar apo konfiskuar;

2.6. evidentimi e një procedure të veçantë që kërkohet të zbatohet gjatë ekzekutimit të kërkesës dhe arsye përkatëse për të;

2.7. vënien në dijeni për nevojën për konfidencialitet;

2.8. çdo informatë tjetër që mund të lehtësojë ekzekutimin e kërkesës.

Pranueshmëria e kërkesës

63. Gjkata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

64. Në këtë drejtim, Gjkata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

65. Gjykata, gjithashtu, shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet: 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
(Afati)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

66. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Më konkretisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

67. Sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, respektivisht Aktgjykimin [Pml. nr. 310/2020] e 28 prillit 2021 të Gjykatës Supreme, në ndërlidhje me dy aktgjykimet e shkallës më të ulët, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesja e kërkesës, po ashtu i ka sqaruar pretendimet e saj për të drejtat dhe liritë që ajo pretendon se i janë shkelur, ashtu siç

përcaktohet me nenin 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

68. Në dritën e fakteve dhe argumenteve të paraqitura me këtë kërkesë, Gjykata konsideron se kërkesa e saj ngre çështje serioze kushtetuese, të cilat kërkojnë shqyrtim të meritave të kërkesës. Për më tepër, kërkesa e parashtrueses së kërkesës nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar, brenda kuptimit të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe nuk ekziston asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme.

Meritat e rastit

69. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesja e kërkesës dhe bashkëshorti i saj, i ndjeri A.S., nga viti 2007 deri në vitin 2018, jetonin në marëdhënie bashkëshortore. Gjithashtu sipas shkresave të lëndës, rezulton që parashtruesja e kërkesës, nga viti 2007 deri në vitin 2018, kishte raportuar dhunën në familje, fillimisht para autoriteteve kosovare dhe më vonë edhe para autoriteteve përkatëse në Republikën e Francës. Bazuar në një numër të shkresave të lëndës vërehet se gjatë kohës sa kishin jetuar në Republikën e Francës, parashtruesja e kërkesës disa herë kishte kërkuar ndihmë dhe strehim për veten dhe dy fëmijët e saj nga autoritetet përkatëse franceze. Më tej, nga shkresat e lëndës, rezulton se bashkëshorti i saj, i ndjeri A.S., kishte qenë i dënuar nga gjykatat franceze, përkatësisht, Gjykata e Lyonit (gusht 2018), për dhunën e ushtruar ndaj parashtrueses së kërkesës dhe më pas ishte liruar me kusht.
70. Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se më 21 shtator 2018, bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës, përkatësisht A.S., ishte privuar nga jeta. Të njëjtën ditë, parashtruesja e kërkesës së bashku me fëmijët e saj ishte nisur nga Republika e Francës për në Republikën e Kosovës. Pas kthimit në Kosovë, parashtruesja e kërkesës ishte lajmëruar në Ambasadën e Republikës së Francës në Prishtinë dhe më pas, ishte arrestuar nga autoritetet e Republikës së Kosovës.
71. Më saktësisht, parashtruesja e kërkesës ishte arrestuar nga autoritetet e Republikës së Kosovës, më 4 tetor 2018, ndërsa Prokuroria Themelore, kishte ngritur aktakuzën kundër parashtrueses së kërkesës nën dyshimin e bazuar se e njëjta ka kryer veprën penale “Vrasje e rëndë” nga neni 179, paragrafi 1, nënparagrafët 1.3 dhe 1.4 të KPRK-së, dhe të cilat përcaktojnë se: *“1. Me dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dënohet personi i cili: [...] 1.3. privon nga jeta anëtarin e familjes; dhe 1.4. privon nga jeta personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake.”* Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [PKR. 37/2019] e shpalli parashtruesen e kërkesës fajtores për kryerjen e veprës penale për të cilën ishte akuzuar, duke e dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 25 (njëzet e pesë) vjet. Më pas, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore me të cilin ishte shpallur fajtores, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Parashtruesja e kërkesës në ankesën e saj në Gjykatën e Apelit, ndër tjerash, në kuptim të parimit të barazisë së armëve kishte pretendime specifike në lidhje me: (i) të drejtën e saj për të ballafaquar dëshmitarët [J.Ch., A.D., H.S., F.L., B.P. dhe L.S.], dëshmitë e të cilëve vetëm ishin lexuar gjatë shqyrtimit kryesor; (ii) faktin që kërkesa e saj për ekzaminim psikiatrik nuk ishte marrë parasysh, dhe sipas saj kjo më së miri do e dëshmonte gjendjen e saj mendore në momentin e kryerjes së veprës penale; dhe (ii) faktin që djali i saj, i mituri X.X., në cilësi të dëshmitarit ishte marrë në pyetje pa praninë e psikologut. Ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit parashtrroi edhe Prokuroria Themelore, duke kërkuar që parashtruesja e kërkesës të dënohet me dënim më të rëndë. Gjykata e Apelit aprovoi pjesërisht ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore vetëm përkitazi me cilësimin juridik të veprës

penale, ashtu që, Gjykata e Apelit veprën penale për të cilën parashtuesja e kërkesës ishte shpallur fajtores, juridikisht e cilësoi si vepër penale “*urasje e rëndë*” nga paragrafi 1, nënparagrafi 3 të nenit 179 të KPRK-së, përderisa ankesën e Prokurorisë Themelore si dhe ankesat e tjera të parashtueses së kërkesës i refuzoi si të pabazuara, duke konfirmuar vendimmarrjen e Gjykatës Themelore. Më pas, parashtuesja e kërkesës në Gjykatën Supreme paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjytimeve të shkallës më të ulët. Në kërkesën e saj për mbrojtje të ligjshmërisë, ajo, ndër tjerash në kuptim të barazisë së armëve, ritheksoi pretendimet e saja që ndërlidhen me: (i) kërkesën e saj të vazhdueshme, të paraqitur para gjykatave të shkallës më të ulët për t’i ballafaquar dëshmitarët, dëshmitë e të cilëve gjatë shqyrtimit gjyqësor vetëm ishin lexuar; (ii) ankesën e saj se rasti i saj nuk ishte trajtuar si rast i dhunës në familje, ku sipas saj ajo ishte viktimë e dhunës në familje; (iii) kërkesën e saj për ekzaminim psikiatrik dhe e cila ishte refuzuar nga gjykatat më të ulëta; si dhe (iv) ritheksoi pretendimin e saj se djali i saj, i mituri X.X., në cilësi të dëshmitarit në Gjykatën Themelore ishte marrë në pyetje pa praninë e psikologut. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [PML nr. 310/2020] në tërësi e refuzoi si të pabazuara kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtuar nga parashtuesja e kërkesës, duke konfirmuar për pasojë vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta.

72. Parashtuesja e kërkesës para Gjykatës i konteston vendimet e lartcekura të gjykatave të rregullta, përkatësisht Aktgjykimin [PKR nr. 37/2019] të 24 janarit 2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Aktgjykimin [PAKR nr. 133/2020] të 3 korrikut 2020 të Gjykatës së Apelit dhe si dhe Aktgjykimin [Pml nr. 310/220] e 28 prillit 2021, të Gjykatës Supreme duke pretenduar shkelje të së drejtave të saj kushtetuese. Më saktësisht, parashtuesja e kërkesës, para gjykatës, ngrit pretendimet, të cilat do të përmbliidhen si në vijim:

- i) parashtuesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë për bazë provat materiale të prezentuara nga mbrojtja e saj, të cilat sipas saj do të shkonin në favor të mbrojtjes e të cilat sipas saj ndërlidhen me “*dhunën permanente që [A.S.] ka ushtruar ndaj paraqitëses së kërkesës, për çka është dënuar me burg nga autoritetet gjyqësore të Francës*”, duke shtuar faktin se Gjykata Themelore nuk i ka marrë parasysh rrethanat që i kanë paraprirë ngjarjes, duke përfshirë faktin që ajo ishte viktimë e dhunës në familje dhe të kaluarën kriminale të të ndjerit A.S.;
- ii) në lidhje me parimin e barazisë së armëve, parashtuesja e kërkesës saktëson që në rastin e saj është shkelur paragrafi 4 i nenit 31 të Kushtetutës, si rezultat i pamundësisë së saj që në asnjë fazë të procedurës së zhvilluar kundër saj t’i marrë në pyetje dëshmitarët, të cilët përmes dëshmisë së tyre kanë ndikuar që parashtuesja e kërkesës të shpallet fajtores;
- iii) po në kuadër të së drejtës në barazi të armëve, parashtuesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta e kishin refuzuar edhe kërkesën e saj të parashtuar për ekzaminim psikiatrik, e cila sipas saj do të vërtetonte gjendjen e saj mendore në momentin e kryerjes së veprës penale;
- iv) parashtuesja e kërkesës më tej pretendon se me rastin e marrjes së dëshmisë së fëmijës së saj [X.X.], i cili kishte qenë i mitur, i njëjti është marrë në pyetje vetëm në praninë e punëtorit social e jo edhe të psikologut;
- v) sipas pretendimeve të parashtueses së kërkesës, aktgjykimet e gjykatave të rregullta janë bazuar në prova të papranueshme, duke shtuar se të njëjtat kanë shpërfillë detyrimet ligjore që specifikojnë “*se provat e siguruara përmes*

rrugëve joformale nga qeveritë e shteteve të huaja, siç ka ndodhur rasti i sigurimit të dëshmitë të dëshmitarëve dhe provave të tjera materiale, raportet e këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe raportet e ekzaminimit mjeko-ligjor, të dërguara nga Franca, janë prova të papranueshme, nëse atyre provave nuk u është bashkëngjitur Deklarata e Qeverisë Franceze apo autoriteteve për zbatim të ligjit se ato dëshmi janë siguruar dhe janë marrë në përputhje me ligjin e atij shteti”.

73. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se procesi gjyqësor i zhvilluar para gjykatave të rregullta, është zhvilluar bazuar në aktakuzën e Prokurorisë Themelore, të ngritur ndaj parashtrueses së kërkesës nën dyshimin e bazuar se ka kryer veprën penale “Vrasje e rëndë” nga neni 179, paragrafi 1, nënparagrafët 1.3 dhe 1.4 të KPRK-së.
74. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesja e kërkesës nuk e ka kontestuar aktin e privimit nga jeta të bashkëshortit të saj, përkatësisht të ndjerit A.S.
75. Gjykata, bazuar në sqarimet e lartcekura dhe në kuadër të fushëveprimit të kërkesës së parashtrueses së kërkesës të parashtruar në Gjykatë, do t’i shqyrtojë pretendimet e saj në kuptim të garancive kushtetuese që ndërlidhen me parimin e barazisë së armëve dhe të drejtës për vendim të arsyetuar gjyqësor, të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
76. Megjithatë, lidhur me pretendimin e parashtrueses së kërkesës që ndërlidhet me marrjen në pyetje të të miturit X.X., në cilësi të dëshmitarit, Gjykata vëren se ky pretendim përveç nenit 31 të Kushtetutës, në substancë ngritë edhe çështje kushtetuese të përcaktuara në paragrafin 3 të nenit 50 [Të Drejtat e Fëmijës] të Kushtetutës, paragrafin 1 të nenit 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, si dhe paragrafin 3 të nenit 18 (Detyrimet e Përgjithshme) të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje (në tekstin e mëtejshme: Konventa e Stambollit).
77. Në kontekst të sqarimeve të dhëna, pretendimet e lartcekura Gjykata do t’i trajtojë duke u referuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshme: GJEDNJ), mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

I. Përkitazi me pretendimin e parashtrueses së kërkesës për shkeljen e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së

78. Fillimisht, në kuadër të këtij pretendimi, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës thekson se në rastin konkret është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe ai i kontradiktoritetit, ndër tjerash, si rezultat i: (i) pamundësisë së saj për të ballafaquar dëshmitarët, dëshmitë e të cilëve vetëm janë lexuar në shqyrtimin gjyqësor, përkundër kërkesës së saj të vazhdueshme të parashtruar para gjykatave të rregullta; (ii) refuzimit të kërkesës së saj nga gjykatat e rregullta për ekzaminim psikiatrik, i cili sipas parashtrueses së kërkesës do të krijonte një pasqyrë më të qartë për motivin dhe gjendjen e saj në momentin e kryerjes së veprës penale; dhe (iii) pretendimin se gjykatat e rregullta nuk i kanë marrë parasysh dëshmitë/provat e prezentuara nga parashtruesja e kërkesës që sipas saj dëshmonin se ajo ishte viktimë e dhunës në familje, dhe si rezultat i kësaj, sipas saj, asaj i ishte pamundësuar për paraqitjen e provave të propozuara nga mbrojtja.

79. Gjykata, në këtë aspekt, fillimisht do të shqyrtojë pretendimet e parashtreses së kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në kuadër të parimit të barazisë së armëve dhe atij të kontradiktoritetit si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Për këtë qëllim, në vijim, Gjykata fillimisht (i) do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme përkitazi me parimin e barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit siç është garantuar përmes neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së; dhe më pas, (ii) do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.
- (i) *Parimet e përgjithshme në bazë të praktikës gjyqësore të Gjykatës, si dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit*
80. Gjykata, duke iu referuar edhe praktikës gjyqësore të saj dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, fillimisht thekson se parimi i “barazisë së armëve” është element i një koncepti më të gjerë të një gjykimi të drejtë (shih, rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtres [Albert Rakipi](#), Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 97). Pajtueshmëria me kërkesat e një gjykimi të drejtë duhet të shqyrtohet në çdo rast duke pasur parasysh zhvillimin e procedurave si tërësi dhe jo në bazë të një shqyrtimi të izoluar të një aspekti të veçantë ose të një incidenti të veçantë, megjithëse nuk mund të përjashtohet që një faktor specifik mund të jetë aq vendimtar sa të mundësojë që drejtësia e gjykimit të vlerësohet në një fazë më të hershme të procedurës (shih, rastin e GJEDNJ-së [Beuze kundër Belgjikës](#), kërkesa nr. 71409/10, Aktgjykim i 9 nëntorit 2018, paragrafi 121).
81. Në përputhje me parimin e barazisë së armëve, si një nga tiparet e konceptit më të gjerë të një gjykimi të drejtë, secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e tij/ saj në kushte që nuk e vendosin atë në pozitë të pafavorshme me palën kundërshtare. Në këtë kontekst, rëndësi i kushtohet paraqitjeve si dhe ndjeshmërisë së shtuar për një administrim të drejtë të drejtësisë (shih, ndër autoritetet e tjera, [Öcalan kundër Turqisë](#), nr. 46221/99, Aktgjykim i 12 majit 2005, paragrafi 140; shih gjithashtu [Bulut kundër Austrisë](#), kërkesa nr. 17358/90, Aktgjykim i 22 shkurtit 1996, paragrafi 47; [Yvon kundër Francës](#), Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 31; dhe [Dombo Beheer B.V. kundër Holandës](#), Aktgjykim i 27 tetorit 1993, paragrafi 33; shih rastet e Gjykatës, [KI230/19](#), cituar më lart, paragrafi 98; dhe [KI103/10](#), parashtres [Shaban Mustafa](#), Aktgjykim i 20 marsit 2012, paragrafi 40). Për më tepër, parimi se rregullat e procedurës penale duhet të përcaktohen me ligj është parim i përgjithshëm i ligjit. Ai qëndron krah për krah me kërkesën që edhe rregullat e së drejtës penale materiale duhet të përcaktohen ngjashëm me ligj që edhe është e përfshirë në maksimumin “*nullum iudicium sine lege*”. Sipas GJEDNJ-së, ligji vendos disa kërkesa specifike lidhur me zhvillimin e procedurave, me synim të garantimit të një gjykimi të drejtë, i cili përfshin respektimin e barazisë së armëve. Qëllimi kryesor i rregullave procedurale është të mbrojnë të pandehurin nga çdo abuzim i autoritetit, dhe për këtë arsye është mbrojtja ajo që ka më shumë gjasa të pësojë nga lëshimet dhe mungesa e qartësisë së këtyre rregullave (shih, rastin e GJEDNJ-së [Coëme dhe të tjerët kundër Belgjikës](#), nr. 32492/96 dhe 4 të tjerë, Aktgjykim i 22 qershorit 2000, paragrafi 102.).
82. Për më tepër, Gjykata gjithashtu thekson se gjykimi i drejtë përfshin edhe të drejtën e gjykimit në pajtim me “parimin e kontradiktoritetit”, parim i cili është i ndërlidhur me parimin e “barazisë së armëve” (shih, rastin e Gjykatës [KI230/19](#), cituar më lart, paragrafi 99). Në kuadër të procedurës penale, GJEDNJ ka nënvizuar se “*[ë]shtë një aspekt themelor i së drejtës për një gjykim të drejtë që procedurat penale, përfshirë edhe elementet e procedurave të tilla që kanë të bëjnë me vet procedurën, duhet të jenë në pajtim me parimin e kontradiktoritetit dhe se duhet të ekzistojë barazia e armëve ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes*” (shih, rastin e GJEDNJ-së [Leas kundër Estonisë](#), kërkesa nr. 59577/08, Aktgjykim i 6 marsit 2012, paragrafi 77). Rrjedhimisht, përkitazi

me parimin e kontradiktoritetit, GJEDNJ theksoi se, në një procedurë penale, si prokuroria ashtu edhe mbrojtja duhet të kenë mundësinë që të kenë njohuri dhe të bëjnë komente për të gjitha vërejtjet dhe për të gjitha provat e paraqitura nga pala tjetër (shih, rastin [Brandstetter kundër Austrisë](#), të cituar më lart, paragrafi 67).

83. Në kuadër të parimeve të përgjithshme lidhur me barazinë e armëve dhe në lidhje me pretendimin e ngritur nga parashtruesja e kërkesës që ndërlidhet me kërkesën e saj për ekzaminimin psikiatrik, Gjykata në vijim do t'i referohet rastit të GJEDNJ-së [Gaggl kundër Austrisë](#), Aktgjykim i 8 nëntorit 2022. Në rastin e lartpërmendur, çështja ka të bëjë me procedurën penale të zhvilluar kundër parashtrueses së kërkesës dhe dënimin për veprën penale tentim vrasje ndaj bashkëshortit të saj. Më saktësisht, në janar 2018, parashtruesja e kërkesës, në mënyrë të përsëritur kishte therrur me thikë dhe tentoi të vriste bashkëshortin e saj me të cilin ishte e martuar. Ajo më vonë dëshmoi se kishte për qëllim ta vriste atë dhe më pas të bënte vetëvrasje. Duke u mbështetur në nenin 6 (E drejta për një gjykim të drejtë) dhe nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së, parashtruesja e kërkesës, ishte ankuar në GJEDNJ që dënimi i saj penal ishte i padrejtë dhe ndalimi i saj ishte i paligjshëm. Në veçanti, ajo ankohej se nuk i është dhënë mundësia për të kuptuar arsyet mbi të cilat juria bazoi bindjen e saj duke qenë se ekspertizat e dy mendimeve të ekspertëve për gjendjen e saj mendore në kohën e veprës penale ishin diametralisht të kundërta dhe se gjykatat vendore hodhën poshtë kërkesën e saj, e cila kishte edhe mbështetjen e prokurorit publik, për të marrë një ekspertizë të tretë dhe vendimtare.
84. Gjithnjë në kuadër të barazisë së armëve në ndërlidhje me çështjen e ekzaminimit psikiatrik në rastin [Gaggl kundër Austrisë](#), GJEDNJ theksoi, ndër tjerash, theksoi se: *“Caktimi i ekspertëve është i rëndësishëm për të vlerësuar nëse është respektuar parimi i barazisë së armëve. Vetë fakti që ekspertët në fjalë angazhohen nga njëra prej palëve nuk mjafton për t'i bërë procedurat të padrejta. Edhe pse ky fakt mund t'i hapë rrugë frikës për neutralitetin e ekspertëve, një frikë e tillë, edhe pse ka rëndësi, nuk është vendimtare. Megjithatë, ajo që është vendimtare është qëndrimi që kanë pasur ekspertët gjatë gjithë procedurës, mënyra se si i kanë kryer funksionet e veta dhe mënyra se si gjyqtarët kanë vlerësuar mendimin e ekspertit. Gjatë konstatimit të qëndrimit procedural të ekspertëve dhe rolit të tyre në procedurë, nuk duhet të harrohet fakti se mendimi i dhënë nga çdo ekspert i caktuar nga gjykata ka të ngjarë të ketë peshë të konsiderueshme në vlerësimin e gjykatës për çështjet brenda kompetencës së atij eksperti (shih, [Poletan dhe Azirovik kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë](#), kërkesa nr. 26711/07 dhe 2 të tjerë, paragrafi 94, 12 maj 2016; dhe [Shulepova kundër Rusisë](#), kërkesa nr. 34449/03, paragrafi 62, 11 dhjetor 2008)”. Në vijim, GJEDNJ në po të njëjtin rast kishte specifikuar se: “... kërkesa për gjykim të drejtë nuk e ngarkon gjykatën me detyrimin për të urdhëruar një mendim eksperti ose çfarëdo mase tjetër hetimore vetëm për shkak se një palë e ka kërkuar atë (shih, rastin e GJEDNJ-së [Hodžić kundër Kroacisë](#), kërkesa nr. 28932/14, § 61, 4 prill 2019; dhe [H. kundër Francës](#), 24 tetor 1989, paragrafi 60; dhe 61, Seria A nr. 162-A). Kur mbrojtja insiston që gjykata të dëgjojë një dëshmitar ose të marrë prova të tjera (si p.sh. një raport eksperti), iu takon gjykatave vendore të vendosin nëse është e nevojshme apo e këshillueshme që ato prova të pranohen për shqyrtim në gjykim (shih rastet e GJEDNJ-së [Khodorkovskiy dhe Lebedev kundër Rusisë](#), kërkesat nr. 11082/06 dhe 13772/05, paragrafi 718 dhe 721, 25 korrik 2013; dhe [Huseyn dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit](#), kërkesa nr. /05, Aktgjykim, i 26 korrikut 2011, paragrafi 196)”.*
85. Në kuptim të rrethanave të rastit konkret, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata citon pjesën relevante të Aktgjykimit të lartpërmendur, respektivisht rastit [Gaggl kundër Austrisë](#), si në vijim: *“Ankesa e saj që gjykimi nuk kishte qenë i shoqëruar me garanci të mjaftueshme të cilat do ta lejonin t'i kuptonte*

arsyet e aktgjykimit, është i lidhur ngushtë me pyetjen nëse ajo kishte qenë në gjendje mendore të atillë e cila e liron nga përgjegjësia penale në kohën e veprës penale, dhe kështu edhe me kërkesën e saj për urdhërimin e mendimit të tretë dhe vendimtar të ekspertit lidhur me gjendjen mendore të saj në atë kohë, me qëllim të krijimit të provave të reja” (paragrafi 56 i Aktgjykimit në rastin Gaggl kundër Austrisë).

86. Andaj, Gjykata në trajtimin e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, do t'i përmbahet parimeve të lartcekura të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të vet Gjykatës për aq sa ato mund të jenë të aplikueshme në rrethanat e rastit konkret.

(ii) Aplikimi i këtyre parimeve në rastin konkret

87. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendimin e saj për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit në mënyrë specifike e ndërlidhë me faktin që, përgjatë procedurave gjyqësore, asaj: (i) i është pamundësuar për të marrë në pyetje dëshmitarët në shqyrtim gjyqësor, dëshmitë e të cilëve vetëm janë lexuar gjatë shqyrtimit gjyqësor; (ii) i është refuzuar kërkesa e saj për ekzaminim psikiatrik; si dhe (iii) i është pamundësuar paraqitja e provave të propozuara nga mbrojtja të cilat, sipas saj, do të vërtetonin që e njëjta ishte edhe viktimë e dhunës në familje, dhe për pasojë do të shkonin në favor të saj.
88. Duke pasur parasysh parimet e lartcekura, Gjykata në vazhdim do të vlerësojë zbatimin e parimeve të lartcekura në rastin konkret, për të përcaktuar nëse pretendimet e parashtrueses së kërkesës kanë rezultuar në shkelje të parimit të barazisë së armëve, respektivisht të drejtës së saj për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç është garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
89. Gjykata edhe një herë rikujton që parashtruesja e kërkesës nuk e ka kontestuar kryerjen e aktit për të cilin është akuzuar. Ankesa e saj që gjykimi nuk kishte qenë i shoqëruar me garanci të mjaftueshme të cilat do ta lejonin që parashtruesja e kërkesës të krijonte bindjen e një gjykimi të drejtë, duke përfshirë përcaktimin e lartësisë së dënimit të saj, është e lidhur ngushtë me çështjet si në vijim: (i) pamundësinë për të ballafaquar dëshmitarët e propozuar nga Prokuroria, dëshmitë e të cilëve vetëm janë lexuar dhe të cilat ishin marrë për bazë nga gjykatat e rregullta; si (ii) nëse pranimi eventuale i kërkesës për ekzaminim psikiatrik do të mund të vërtetonte gjendjen e saj mendore, marrë parasysh faktin se parashtruesja e kërkesës për kohë të gjatë pranë institucioneve relevante si në Kosovë edhe në Francë kishte raportuar se kishte qenë viktimë e dhunës në familje (siç është paraqitur në mënyrë të detajuar tek përmbledhja e fakteve); si dhe (iii) pretendimit se parashtrueses së kërkesës nuk i janë lejuar që të paraqes prova të cilat sipas saj do të shkonin në favor të mbrojtjes.
90. Në vijim, Gjykata këto tri pretendime të parashtrueses së kërkesës në kuadër të parimit të barazisë së armëve do t'i trajtojë ndaras, duke filluar me pretendimin e saj për pamundësinë e saj për të ballafaquar dëshmitarët për të vazhduar me dy pretendimet e tjera të lartcekura.
- (a) lidhur me pamundësinë për të ballafaquar dëshmitarët e propozuar nga Prokuroria, dëshmitë e të cilëve vetëm janë lexuar dhe të cilat ishin marrë për bazë nga gjykatat e rregullta*
91. Gjykata fillimisht vëren se këtë pretendim specifik parashtruesja e kërkesës e kishte ngritur në mënyrë specifike para të gjitha instancave gjyqësore. Parashtruesja e kërkesës i kishte kundërshtuar të gjitha dëshmitë të cilat janë lexuar gjatë shqyrtimit

gjqësor duke i pamundësuar parashtrueses së kërkesës që të njëjtat t'i kundërshojë, dëshmi këto të marra nga autoritetet franceze ku edhe është kryer vepra penale. Dëshmitë të cilat parashtruesja e kërkesës i kishte kundërshtuar pikërisht për faktin e pamundësisë së ballafaqimit me dëshmitarë, pretendim ky të cilin e ka ngritur edhe në Gjykatë, janë ato dëshmi të cilat sipas saj para gjykatave të rregullta përbëjnë bazë për përcaktimin e raporteve bashkëshortore në mes të parashtrueses së kërkesës dhe bashkëshortit të saj A.S., si dhe sipas saj, përcaktuese të faktit se cilat rrethana i kishin paraprirë kryerjes së veprës penale. Gjykata rikujton se bazuar në shkresa të lëndës dhe plotësimin e kërkesës së saj në lidhje me të drejtën për barazi të armëve, parashtruesja e kërkesës asnjëherë nuk ka pasur mundësi që t'i marrë në pyetje apo t'i ballafaqojë dëshmitarët e lartcekur.

92. Në vijim të adresimit të këtij pretendimi, Gjykata i referohet fillimisht Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, ku është theksuar se deri tek përcaktimi i fajësisë së parashtrueses së kërkesës ka ardhur pas administrimit të një numri të madh provash, duke filluar nga moskontestimi i privimit nga jeta nga ana e parashtrueses së kërkesës të të ndjerit A.S., por duke përfshirë dhe mos u kufizuar, ndër të tjera edhe në deklaratat e dëshmitarëve [J.Ch., A.D., H.S., F.L., B.P. dhe L.S.], të cilat janë lexuar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe të cilat dëshmi parashtruesja e kërkesës asnjëherë nuk ka pasur mundësi që t'i kundërshtojë.
93. Përkitazi me dëshmitë e lartcekura të cilat vetëm janë lexuar në shqyrtim gjyqësor, Gjykata vëren se të njëjtat kanë dëshmuar për raportet martesore në vazhdimësi jo të mira në mes të parashtrueses së kërkesës dhe të ndjerit A.S., (dëshmi këto të cilat bazuar në shkresat e lëndës sipas parashtrueses së kërkesës dëshmojnë lidhur me karakterin jo stabil të parashtrueses së kërkesës), po ashtu rezulton se disa nga këta dëshmitarë (bazuar në shkresa të lëndës) ishin fqinjët e tyre, deklaratat/dëshmitë e të cilëve ishin marrë për bazë në cilësimin e karakterit të parashtrueses së kërkesës. Këta dëshmitarë parashtruesja e kërkesës asnjëherë nuk ka pasur mundësi që t'i ballafaqojë.
94. Më tej, Gjykata Themelore në arsyetim të Aktgjykimit të saj kishte potencuar faktin se dëshmitë e lartpërmendura, të lexuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk kanë qenë përcaktuese për përcaktimin e motivit të kryerjes së veprës penale, pasi këta të fundit nuk kanë qenë dëshmitarë okular të ngjarjes. Megjithatë, Gjykata vëren se po të njëjtat dëshmi janë administruar nga Gjykata Themelore dhe i janë referuar të njëjtave për të vërtetuar faktin se si ka ardhur deri te ngjarja kritike, përkatësisht e ndër të tjera edhe përcaktuese për motivin që e kishte shtyrë parashtruesen e kërkesës të kryejë aktin.
95. Gjykata rikujton se pamundësia e parashtrueses së kërkesës për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër saj, nga e njëjta ishin ngritur si pretendime përmes ankesës së saj të parashtruar në Gjykatën e Apelit dhe në kërkesën e saj për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar në Gjykatën Supreme. Thënë këtë, nga kjo rezulton se pretendimet e saj të ngrituara përmes këtyre dy parashtrësive respektive ishin shqyrtuar nga Gjykata e Apelit, si dhe nga Gjykata Supreme.
96. Gjykata, më tutje në ndërlidhje me pretendimin e parashtrueses së kërkesës për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër saj, në kuadër të plotësimit të kërkesës për barazi të armëve, rikujton edhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit e cila e vërtetoi në këtë pikë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke theksuar, ndër tjerash, se: “ ... ajo ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe ekspertizën mjeko-ligjore, pastaj, deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor, e të cilat edhe ashtu nuk ndryshojnë në kuptim të vërtetimit të fakteve themelore, sidomos përkitazi me vërtetimin e fakteve dhe rrethanave se si erdhi deri tek privimi nga jeta i tani të ndjerit A.S. fakte dhe rrethana

kyto qe nuk i kundërshton as vet e akuzuara, por qe pretendon se në momentin kritik ka qenë e sulmuar nga tani i ndjeri [...], mirëpo nga shkresat e lëndës dhe nga provat e tjera materiale vërtetohet se edhe provat në fjalë, gjykata e shkallës së parë i ka marrë parasysh dhe atë sidomos të dhëna përkitazi me të kaluarën e të akuzuarës dhe tani të ndjerit, në kuptim të jetës bashkëshortore, pastaj nga deklarata e dëshmitarëve – fqinjëve të akuzuarës ka vërtetuar edhe sjelljen e të akuzuarës ndaj tani të ndjerit, sjellje këto, pra, qe nuk kanë qenë të atij niveli qe do të mund të konkludohej se vetëm tani i ndjeri ka pasur sjellje të dhunshme, ngase edhe për të akuzuarën dëshmitarët në fjalë kanë vërtetuar sjellje agresive të akuzuarës në raport me të ndjerin, prandaj, Gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka refuzuar për sigurimin edhe të provave tjera materiale nga shteti i Francës, përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë”.

97. Nga citimi i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, “[...], për të akuzuarën dëshmitarët në fjalë kanë vërtetuar sjellje agresive të akuzuarës në raport me të ndjerin, prandaj, Gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka refuzuar për sigurimin edhe të provave tjera materiale nga shteti i Francës, përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë”. Gjykata vëren se dëshmitë e dëshmitarëve janë marrë parasysh në cilësimin e personalitetit të parashtrueses së kërkesës, përcaktimin e motivit të veprës penale, si dhe në përcaktimin e lartësisë së dënimit përkatës.
98. Në kuptim të këtij pretendimi, Gjykata gjithashtu i referohet edhe pjesës së arsytimit të dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, ku kjo e fundit, duke u mbështetur në nenin 262 të KPPK-së, thekson se: “Në këtë çështje juridiko-penale, duke pasur parasysh faktin se vrasja është kryer në Francë, dhe pas kryerjes së vrasjes e dënuara ka ardhur në Kosovë ku edhe është arrestuar është evidente se një mori provash janë siguruar nga autoritetet e organeve kompetente të Francës, në mesin e tyre edhe dëshmitë e dëshmitarëve J.C., A. D. dhe H. S. të cekura në kërkesa dhe këto dëshmi e dënuara nuk ka mundur që në shqyrtimin gjyqësor t’i kundërshtoj përmes marrjes në pyetje, por nga ky fakt nuk mund të pretendohet se ato janë të papranueshme siç pretendohet në kërkesës, ngase me dispozitën e nenit 262 parashihet se këto prova nuk e përcaktojnë fajsinë e që në rastin konkret nuk e kanë përcaktuar ngase bëhet fjalë për dëshmitë e dëshmitarëve që kanë treguar për raportet e tyre me të ndjerin dhe të dënuaren. Pastaj nuk janë prova kryesore për ta vërtetuar faktin më të rëndësishëm nëse natën kritike kishte fjalosje dhe konflikt fizik në mes të dënuarës dhe të ndjerit ashtu siç pretendon mbrojtësja, ngase nuk janë dëshmitarë okular të ngjarjes (në këtë çështje nuk ka dëshmitar okular të ngjarjes për të treguar se si është zhvilluar ngjarja kritike) dhe as që gjykata i ka vlerësuar si prova të tilla”.
99. Nga gjithë ajo që u tha më lart, respektivisht nga arsyetimet e gjykatave të rregullta që ndërliken me këtë pretendim specifik, Gjykata vëren se, ashtu siç kanë konstatuar gjykatat e rregullta, dispozitat përkatëse procedurale, mundësojnë pranimin e dëshmimeve të dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor nëse paraqitja para gjykatës e këtyre dëshmitarëve është e pamundur. Megjithatë, bazuar në elaborimin e si më sipër të parimeve të përgjithshme që ndërliken me parimin e kontradiktoritetit, të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata rikujton që një aspekt themelor i së drejtës për një gjykim të drejtë është që procedurat penale, përfshirë edhe elementet e një procedure të tillë që kanë të bëjnë me vetë procedurën, çështja e pranimi dhe administrimit të provave duhet të jenë në pajtim me parimin e kontradiktoritetit dhe se duhet të ekzistojë barazia e armëve ndërmjet prokurorisë në njërin anë dhe mbrojtjes në anën e tjetër.
100. Më tej, Gjykata po ashtu vëren se përgjatë arsytimit në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, qëndrim ky së pari i pranuar nga Gjykata e Apelit, dhe më pas edhe nga Gjykata Supreme, dëshmitë të cilat parashtruesja i konteston në kuadër të parimit të

barazisë së armëve, të njëjtat dëshmi janë përdorur nga vetë këto gjykata, edhe pse këto të fundit të njëjtat dëshmi nuk i kishin vlerësuar dhe konsideruar si kruciale për përcaktimin e fajësisë së saj (duke theksuar ndër të tjera se këta dëshmitarë nuk kanë qenë dëshmitarë okular të ngjarjes). Kjo për arsye se të njëjtat dëshmi, gjithmonë sipas vlerësimit të gjykatave të rregullta mund të kenë kontribuar në krijimin e një pasqyre lidhur me sjelljet e parashtrueses së kërkesës dhe atributet e karakterit dhe personalitetit “*agresiv*” të saj, duke rezultuar, ndër tjerash, edhe në saktësimin e motivit të veprës penale dhe përcaktimin e lartësisë së dënimit përkatës.

101. Gjykata nuk e konteston faktin se gjykatat e rregullta kanë administruar edhe një numër të madh provash materiale të cilat janë elaboruar në këtë Aktgjykim, duke përfshirë edhe moskontestimin e kryerjes së aktit penal nga ana e parashtrueses së kërkesës, përfshirë edhe raportet e ndryshme të vendit të ngjarjes dhe raportet e autopsisë të autoriteteve franceze.
102. Nga si më sipër, si dhe nga leximi i dosjes së rastit, përfshirë nga arsyetimet e vendimeve të gjykatave të rregullta, Gjykata konsideron se dëshmitë e lexuara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk kanë mundur që të ballafaqohen nga parashtruesja e kërkesës dhe të njëjtat nuk janë konsideruar si prova kruciale për ta vërtetuar faktin më të rëndësishëm rreth fajësisë së saj. Megjithatë, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta këtyre dëshmime iu kishin dhënë peshë të konsiderueshme e që për pasojë, kanë rezultuar në vënjen në dukje të elementeve agresive të karakterit dhe personalitetit të saj e që për pasojë kanë rezultuar edhe në përcaktimin e lartësisë së dënimit të saj, dëshmi këto të cilat, parashtruesja e kërkesës nuk kishte mundësi që t'i kundërshtojë, siç kërkohet nga garancitë procedurale të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
103. Për më tepër, marrë parasysh faktin se këto dëshmi i referohen personalitetit apo sjelljes së parashtrueses së kërkesës dhe faktin se parashtruesja e kërkesës gjatë gjithë procedurës penale të zhvilluar kundër saj kishte kërkuar t'i lejohej ballafaqimi me ta, Gjykata vlerëson se në rastin konkret gjatë procedurës së zhvilluar para gjykatave të rregullta është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit, dhe se ky pretendim nuk ishte marrë për bazë as në nivel të shqyrtimit të ankesës së saj në Gjykatë të Apelit dhe as gjatë shqyrtimit të kërkesës së saj për mbrojtjen e ligjshmërisë nga ana e Gjykatës Supreme.
104. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata vë theks në faktin që GJEDNJ gjithashtu ka theksuar se duke marrë parasysh rëndësinë e administrimit të drejtë të drejtësisë në një shoqëri demokratike, çdo masë që kufizon të drejtat e mbrojtjes duhet të jetë rreptësisht e nevojshme. Nëse një masë më pak kufizuese mund të mjaftojë, atëherë ajo duhet të zbatohet (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Van Mechelen dhe të tjerët kundër Holandës](#), Aktgjykim i 23 prillit 1997, paragrafi 58). Mundësia e të akuzuarit që të përballet me dëshmitarët në prani të një gjyqtari është një element qenësor i një procesi gjyqësor të drejtë (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, [Tarau kundër Rumanisë](#), Aktgjykim i 24 shkurtit 2009, paragrafi 74).
105. Marrë parasysh rëndësinë e të drejtës së të akuzuarit për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij, një praktikë e konsiderueshme gjyqësore e GJEDNJ-së është fokusuar në rastet kur dëshmitarët nuk kanë marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor, duke i pamundësuar kështu të akuzuarit dhe mbrojtjes së tij, marrjen e tyre në pyetje dhe kundërshtimin e argumenteve përkatëse. Ndër të tjera, në rastet e GJEDNJ-së, [AI-Khawaja dhe Tahery kundër Mbreterisë së Bashkuar](#) dhe [Schatschaschwili kundër Gjermanisë](#), ajo ka përcaktuar parimet e përgjithshme të aplikueshme në rastet e tilla, dhe testin, të njohur

si testi *Al-Khaëaja dhe Tahery*, i cili duhet të aplikohet nga gjykatat, në të gjitha rastet kur dëshmitarët nuk kanë marrë pjesë në shqyrtimin gjyqësor.

106. Në kuptim të parimeve të përgjithshme të përcaktuar përmes praktikës së lartcekur gjyqësore të GJEDNJ-së, kjo e fundit ka theksuar që në raste të tilla, (i) gjykata përkatëse duhet së pari të shqyrtojë pyetjen paraprake, përkatësisht nëse ka pasur arsye të qëndrueshme për pranimin e dëshmisë së dëshmitarit në mungesë, duke pasur parasysh që, si rregull i përgjithshëm, dëshmitarët duhet të japin dëshmitë gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe se duhet të bëhen të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar pjesëmarrjen e tyre; (ii) kur dëshmitari nuk është marrë në pyetje në asnjë fazë të mëparshme të procedurës, pranimi i deklaratës së dëshmitarit në vend të dëshmive të drejtpërdrejta në proces gjyqësor duhet të jetë masa e fundit; (iii) pranimi si dëshmi i deklaratave të dëshmitarëve në mungesë rezulton në një disavantazh potencial për të akuzuarin, i cili, në parim, duhet të ketë mundësi efektive për të kundërshtuar dëshmitë kundër tij. Në veçanti, ai duhet të jetë në gjendje të testoj vërtetësinë dhe besueshmërinë e dëshmive të dhëna nga dëshmitarët, duke siguruar marrjen e tyre në pyetje në praninë e tij, qoftë në kohën kur dëshmitari e jep deklaratën ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës; (iv) sipas "*rregullit të vetëm ose vendimtar*" (sole or decisive rule), nëse dënimi i të akuzuarit bazohet vetëm ose kryesisht në dëshmi të siguruar nga dëshmitarë të cilët i akuzuari nuk ka patur mundësi t'i marrë në pyetje në ndonjë fazë të procedurës, të drejtat e mbrojtjes janë të kufizuara padrejtësisht, (v) megjithatë, duke marrë parasysh që pika d) e paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së duhet të interpretohet në kuptim të rregullsisë së përgjithshme të procedurës, "*rregulli i vetëm ose vendimtar*" nuk duhet të zbatohet në mënyrë jofleksibile.
107. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së njeh raste të ndryshme në të cilat nuk mund të realizohet paraqitja e një dëshmitari në shqyrtim gjyqësor. Por, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, në rast se pamundësia për të marrë në pyetje dëshmitarët ose për të kërkuar që të merren në pyetje, është për shkak të faktit që ata nuk mund të gjinden në shtetin ku zhvillohet procedura, autoritetet përkatëse duhet të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të siguruar praninë e tyre në gjykatë (shih, rastet e GJEDNJ-së, [*Karpenko kundër Rusisë*](#), Aktgjykim i 13 marsit 2012, paragrafi 62; [*Damir Sibgatullin kundër Rusisë*](#), Aktgjykim i 24 prillit 2012, paragrafi 51; [*Pello kundër Estonisë*](#), Aktgjykim i 12 prillit 2007, paragrafi 35; [*Bonev kundër Bullgarisë*](#), Aktgjykim i 8 qershorit 2006, paragrafi 43; [*Schatschaschëili kundër Gjermanisë*](#), cituar më lart, paragrafi 119; dhe [*Vronchenko kundër Estonisë*](#), Aktgjykim i 18 korrikut 2013, paragrafi 58). Fakti që një gjykatë nuk ka qenë në gjendje të lokalizoj dëshmitarin përkatës ose fakti që ky dëshmitarë nuk është gjendur në shtetin në të cilin zhvillohet procedura, nuk është arsye e mjaftueshme për të plotësuar kërkesat e pikës d) të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së (shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, [*Gabrielyan kundër Armenisë*](#), cituar më lart, paragrafi 81; [*Lucie kundër Kroacisë*](#), Aktgjykim i 27 shkurtit 2014; [*Schatschaschëili kundër Gjermanisë*](#), cituar më lart, paragrafi 120; [*Seton kundër Mbretërisë së Bashkuar*](#), cituar më lart, paragrafi 61; [*Tseber kundër Republikës Çeke*](#), cituar më lart, paragrafi 48; dhe [*Kostecki kundër Polonisë*](#), Aktgjykim i 4 qershorit 2013, paragrafët 65 dhe 66). Kjo e fundit, kërkon që shtetet përkatëse duhet të ndërmarrin hapa konkret për t' i mundësuar të akuzuarit marrjen në pyetje të dëshmitarit kundër tij (shih rastin e GJEDNJ-së, [*Schatschaschëili kundër Gjermanisë*](#), cituar më lart, paragrafi 120; [*Gabrielyan kundër Armenisë*](#), cituar më lart, paragrafi 78; dhe [*Kostecki kundër Polonisë*](#), cituar më lart, paragrafi 65 dhe 66).
108. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk i takon kësaj të fundit që të përpilojë një listë të masave specifike që gjykatat e rregullta duhet të ndërmarrin për të siguruar praninë e dëshmitarit përkatës, megjithatë, është e qartë që autoritetet përkatëse duhet të kenë kërkuar në mënyrë aktive dëshmitarin përkatës edhe nëpërmes autoriteteve

përkatëse dhe kur është e nevojshme, duhet të kenë përdorur ndihmën ndërkombëtare juridike atëherë kur një dëshmitarë jeton jashtë shtetit përkatës. Për më tepër, në mënyrë që të konsiderohet të jenë ndërmarrë të gjithat masat e arsyeshme për të siguruar praninë e dëshmitarit, duhet të ketë pasur edhe kontroll e vlerësim të detajuar të arsyeve të dhëna dhe rrethanave specifike të një dëshmitari, për mospjesëmarrjen e tij/saj në një gjykim nga ana e gjykatës (shih rastin e GJEDNJ-se, *Schatschaschëili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafët 120 dhe 121).

109. Për më tepër, në rastin *Schatschaschëili kundër Gjermanisë*, GJEDNJ identifikoi një sërë elementesh që janë të rëndësishëm në këtë kontekst, duke përfshirë si në vijim: (i) nëse gjykatat vendore i qasen me kujdes dëshmime jashtëgjyqësore të një dëshmitari në mungesë, duke pasur parasysh faktin se dëshmia e tillë mbartë më pak peshë dhe nëse kanë dhënë arsyetime të hollësishme se pse ata e kanë konsideruar atë dëshmi të besueshme, duke pasur parasysh gjithashtu dëshmitë tjera në dispozicion; (ii) ekzistenca e një video-regjistrimi të marrjes në pyetje të dëshmitarit në mungesë në fazën e hetimit, në mënyrë që gjykata, prokuroria dhe mbrojtja të krijojnë përshtypjet përkatëse përkitazi me besueshmërinë e dëshmisë; (iii) disponueshmeria në gjykim e dëshmime mbështetëse që mbështesin dëshminë jashtëgjyqësore të dëshmitarit në mungesë, siç janë deklaratat e bëra në gjykim nga personat të cilëve dëshmitari në mungesë iu ka raportuar ngjarjet menjëherë pas ndodhjes së tyre; (iv) dëshmi të tjera faktike, prova mjeko-ligjore dhe ekspertiza; (v) përshkrimi i ngjarjeve nga dëshmitarë të tjerë, në veçanti nëse dëshmitarët e tillë merren në pyetje të tërthortë gjatë gjykimit; (vi) mundësia që mbrojtja e të akuzuarit t'i parashtrojë pyetjet e veta ndaj dëshmitarit në mungesë në mënyrë të tërthortë, për shembull me shkrim, gjatë gjykimit ose, sipas rastit, në fazën e procedurës paraprake; dhe/ose (vii) mundësia që i akuzuari ose mbrojtësi tij të merr në pyetje dëshmitarin gjatë fazës së hetimit.
110. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rithekson se, bazuar në arsyetimet specifike të gjykatave të rregullta, veçanërisht në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme që ndërlidhen me pretendimin për pamundësinë e ballafaqimit të dëshmitarëve të lartpërmendur në shqyrtim gjyqësor, Gjykata, duke u bazuar edhe në sqarimet e lartcekura që ndërlidhen me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, vlerëson se nuk ka një arsye të qëndrueshme dhe të arsyeshme të dhënë nga gjykatat e rregullta që do të arsyetonin mospraninë e dëshmitarëve në shqyrtimin gjyqësor.
111. Gjykata, për më tepër dhe si rezultat i gjithë asaj që u tha më lart, nuk vëren asnjë përpjekje të gjykatave të rregullta përgjatë gjithë zhvillimit të procedurës gjyqësore, që (i) të sigurohet prania e dëshmitarëve në çfarëdo mënyre; dhe (ii) nuk rezultojnë se gjykatat e rregullta kanë tentuar në ndonjë mënyrë të ftojnë dëshmitarët të jenë prezent gjatë shqyrtimit gjyqësor qoftë përmes një mekanizimi të videolink-ut apo metode tjetër të përshtatshme, që parashtrueses së kërkesës do t'i mundësohej ballafaqimi me ta.
112. Në dritën e gjithë asaj që u tha më lart, Gjykata thekson se në kuadër të parimit të barazisë së armëve nuk është ndërmarrë asnjë veprim procedural në mënyrë që parashtruesja e kërkesës të jetë e dëgjuar dhe të ketë mundësinë e ballafaqimit të dëshmitarëve apo dëshmime të këtyre të fundit.
113. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se si rezultat i pamundësisë që parashtruesja e kërkesës të ballafaqojë dëshmitarët, në procedurën penale të zhvilluar para gjykatave të rregullta nuk janë respektuar garancitë procedurale të mishëruara në paragrafin 4 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me pikën d) të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së.

(b) lidhur me refuzimin e kërkesës së saj për ekzaminim psikiatrik

114. Në këtë drejtim, Gjykata edhe një herë rikujton pretendimet e parashtrueses së kërkesës lidhur me refuzimin e gjykatave të kërkesës së saj për ekzaminim psikiatrik, pretendime këto të cilat parashtruesja e kërkesës në vazhdimësi i kishte ngritur përgjatë zhvillimit të gjithë procedurës penale kundër saj. Më specifikisht, kërkesën e saj për ekzaminim psikiatrik, parashtruesja e kërkesës, së pari e kishte ngritur përgjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën Themelore, dhe më pas pretendimin e saj për cenim të parimit të barazisë së armëve si rezultat i refuzimit të kërkesës së saj, ajo e kishte ngritur edhe në ankesën e saj në Gjykatën e Apelit dhe në fund edhe në kërkesën e saj për mbrojtje të ligjshmërisë para Gjykatës Supreme.
115. Në ndërlidhje me këtë pretendim të parashtrueses së kërkesës, Gjykata së pari rikujton esencën e pretendimit të parashtrueses së kërkesës, e cila para Gjykatës thekson se ekzaminimi psikiatrik në rastin e saj do të vërtetonte motivin dhe gjendjen e saj mendore në momentin e kryerjes së veprës penale.
116. Gjykata rikujton që parashtruesja e kërkesës në ndërlidhje me pretendimet e lartpërmendura, ndër tjerash, thekson se: *“... duke anashkaluar të drejtën e palës mbrojtëse për propozimin e provave që kanë të bëjnë me vërtetimin e fakteve shfajësuese për të akuzuarën, siç ishte edhe propozimi për ekzaminimin psikiatrik të saj për të vërtetuar gjendjen e saj psikike në momentin e kryerjes së veprës penale, vërtetimin e ekzistimit të afektit të akumuluar si pasojë e keqtrajtimit të vazhdueshëm të saj [...]”*.
117. Gjykata gjithashtu sërish rithekson se, duke u bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesja e kërkesës nuk e konteston faktin se ajo e kishte kryer veprën penale për të cilën ishte akuzuar, megjithatë parashtruesja e kërkesës përgjatë procedurës penale të zhvilluar ndaj saj, kishte kërkuar që asaj t’i lejohet ekzaminimi psikiatrik, sepse sipas saj përmes ekzaminimit psikiatrik do të vërtetohej edhe gjendja e saj psikike dhe motivi që e kishte shtyrë për të kryer veprën penale.
118. Në ndërlidhje me këtë kërkesë specifike të parashtrueses së kërkesës, bazuar në shkresat e lëndës dhe në vendimet e gjykatave të rregullta, rezulton se këto të fundit kishin refuzuar këtë kërkesë të parashtrueses së kërkesës për ekzaminim psikiatrik me arsyetimin se nuk kishte asnjë arsye që të aprovohej kërkesa për ekzaminim psikiatrik. Në vijim, gjykatat e rregullta vlerësuan se nga provat që ishin administruar nuk rezulton se parashtruesja e kërkesës të ketë shfaqur ndonjë shqetësim pas kryerjes së veprës penale. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata Themelore ishte thirrur kryesisht në faktin se parashtruesja e kërkesës pasi kishte kryer veprën penale, kishte marrë fëmijët dhe sipas gjykatës së lartcekur, në mënyrë shumë të qetë nga Franca kishte ardhur në Kosovë, duke mos manifestuar ndonjë shenjë që do ta vënte në pikëpyetje gjendjen e saj mendore.
119. Gjykata në vazhdim do t’i referohet arsyetimeve të dhëna nga të gjitha instancat gjyqësore në përgjigje të kërkesës specifike të parashtrueses së kërkesës për ekzaminim psikiatrik.
120. Së pari, Gjykata Themelore refuzoi kërkesën e parashtrueses për ekzaminim psikiatrik me arsyetimin se *“[...] nuk ka pasur asnjë provë bindëse se parashtruesja e kërkesës ka manifestuar ndonjë sjellje e cila do të vinte në pikëpyetje aftësinë e veprimeve të saj”*. Megjithatë, vet Gjykata Themelore, në pjesën e arsyetimit i trajton veprimet e parashtrueses edhe nga aspekti i psikoanalizës, duke theksuar, ndër tjerash, se: *“[...] përderisa vet e akuzuara rrëfen një skenar të një ngjarje të pa qenë kinse me abuzimin e të miturit, e që vërtetë edhe Hiqkoku do ia kishte zili të njëjtës për ndërtimin e një skenari të tillë imagjinar”*.

121. Për më tepër, Gjykata Themelore në arsyetim shtoi se parashtruesja e kërkesës nuk ka vepruar në kushte të mbrojtjes së nevojshme, duke theksuar se rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, dhe se me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethana rënduese kjo e fundit ka marrë parasysh rrethanat e kryerjes së veprës penale, këmbëngulësinë e parashtrueses së kërkesës për të kryer veprën penale dhe sjelljen e saj pas kryerjes së veprës penale. Gjykata Themelore, kishte theksuar se në përcaktimin e lartësisë së dënimit të saj, nuk kishte gjetur dhe rrjedhimisht vlerësuar, asnjë rrethanë lehtësuese.
122. Gjykata po ashtu vëren se po në kuadër të parimit të barazisë së armëve, parashtruesja e kërkesës ka ngritur çështjen e ekzaminimit psikiatrik edhe përmes ankesës së saj, të parashtruar në Gjykatën e Apelit. Arsyetimi dhe qëndrimi i dhënë në këtë pikë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore ishte mbështetur plotësisht edhe nga Gjykata e Apelit por edhe ajo Supreme.
123. Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj, lidhur me kërkesën e parashtrueses së kërkesës për ekzaminim psikiatrik, shtoi se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar kërkesën duke dhënë arsye të qarta për këtë refuzim. Më tutje, lidhur me këtë pretendim, Gjykata Supreme specifikoi se asnjë provë nuk e mbështetë faktin se parashtruesja e kërkesës në këtë pikë nuk kishte qenë e aftë të përgjigjet për veprimet e saj. Më konkretisht, Gjykata Supreme, ndër tjerash, arsyeton se: *“përkitazi me shkelje të ligjit penal siç del nga përmbajtja e kërkesës, mbrojtësja pretendon se në rastin konkret është shkelur ligji penal, ngase sipas mbrojtjes së të dënuarës dhe provave materiale e dënuara ka vepruar në mbrojtje të nevojshme si pasojë e abuzimit seksual të të ndjerit me të miturin dhe keqtrajtimin apo dhunën e përdorur të të ndjerit ndaj të dënuarës natën kritike, e të cilat rrethana flasin për vrasje të kryer në mbrojtje të nevojshme nga neni 179, par. 1 pika 3 lidhur me nenin 12 par. 1 përkatësisht 4 të KPRK-së. Mirëpo, këto pretendime kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara. Së pari, në këtë çështje juridiko penale nuk rezulton kontestues fakti se raportet bashkëshortore në mes të dënuarës dhe të ndjerit nuk ishin të mira dhe se i ndjeri ka përdorur dhunë ndaj të dënuarës, por përkitazi me momentin kritik nuk ka dëshmitar okular të ngjarjes.[...] sa i përket propozimit të mbrojtëses për ekspertizën psikiatrike për të vërtetuar gjendjen psikike të të dënuarës në momentin e kryerjes së veprës penale, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar një propozim të tillë dhe në këtë drejtim ka dhënë arsye të qarta të cilat si të drejta i aprovon edhe kjo gjykatë. E dënuara fillimisht kishte jetuar me familjen e të dënuarit, pastaj kishin shkuar në Francë dhe atje një kohë kishte jetuar vetëm dhe sipas kërkesës së saj edhe i ndjeri kishte shkuar në Francë për të jetuar me të [...] Pastaj, nga shkresat e lëndës nuk rezulton asnjë provë që e argumenton faktin se e dënuara natën kritike kishte pësuar lëndime nga i ndjeri, andaj edhe pretendimet në këtë drejtim janë të pabazuara dhe për këtë gjykatë nuk është e qartë se në çka mbrojtja e mbështet këtë pretendim. Në fakt, rezulton se gjykata ka refuzuar të administroj raportet mjekësore para ngjarjes kritike, por në shkresat e lëndës nuk ka prova që e argumentojnë faktin se e dënuara natën kritike kishte pësuar lëndime nga i ndjeri”.*
124. Bazuar në parimet e cekura si më lart në kuptim të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, rezulton se gjykatave të rregullta nuk u imponohet detyrimi për të urdhëruar një ekspertizë psikiatrike, thjesht vetëm pse parashtruesja e kërkesës e ka kërkuar një gjë të tillë. Megjithatë, Gjykata vë në dukje, ndër të tjera, se bazuar në nenin 508 të KPPK-së, parashihet se: *“Në çdo kohë gjatë procedurës, duke përfshirë kohën gjatë shqyrtimit gjyqësor, nëse ekziston dyshimi se i pandehuri ka qenë në gjendje të paafëtisë mendore ose në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale apo nëse ka ndonjë çrregullim mendor, gjykata sipas detyrës zyrtare*

ose me propozimin e prokurorit të shtetit apo të mbrojtësit, mund të caktojë ekspert sipas nenit 146 të këtij Kodi për të kryer ekzaminimin psikiatrik të të pandehurit”.

125. Në vijim të elaborimit të parimeve të lartcekura të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe arsytiveve të dhëna nga gjykatat e rregullta, Gjykata vendos theksin në atë se ky pretendim i parashtrueses së kërkesës duhet të shqyrtohet dhe vlerësohet në kuptim të garancisë së rregullave procedurale penale, të cilat garanci në mënyrë specifike ndërlidhen me parimin e barazisë së armëve. Gjykata rikujton qëndrimin e GJEDNJ-së në rastin *Gaggl kundër Austrisë* në të cilin gjykatat austriake, në një rast që ndërlidhej me tentim-vrasjen e bashkëshortit të parashtrueses përkatëse, kishin aprovuar kërkesën për ekzaminim psikiatrik dy herë radhazi. Megjithatë, GJEDNJ në këtë rast kishte konstatuar shkelje në kuptim të parimit të barazisë së armëve sepse gjykatat austriake nuk kishin aprovuar kërkesën për ekzaminim psikiatrik edhe nga eksperti i tretë, ndër tjerash, duke marrë parasysh që dy ekspertizat paraprahe ishin kundërthënëse.
126. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata rikujton arsyetimin e Aktgjykimit të GJEDNJ-së në rastin *Gaggl kundër Austrisë*, përkatësisht në paragrafin 60 të këtij Aktgjykimi, ku ndër të tjera lidhur në rrethanat e tentim-vrasjes së bashkëshortit, GJEDNJ kishte theksuar se: “[...] se të dy ekspertët u pajtuan në diagnozën e tyre për sëmundjen mendore të parashtrueses, por arritën në konkludime të ndryshme për ndikimin e saj në gjendjen mendore në kohën e kryerjes së veprës. [...] caktimi i ekspertëve është i rëndësishëm për të vlerësuar nëse është respektuar parimi i barazisë së armëve. Vetë fakti që ekspertët në fjalë angazhohen nga njëra prej palëve nuk mjafton për t’i bërë procedurat të padrejta. Edhe pse ky fakt mund t’i hapë rrugë frikës për neutralitetin e ekspertëve, një frikë e tillë, edhe pse ka rëndësi, nuk është vendimtare”.
127. Më tej, GJEDNJ në rastin *Gaggl kundër Austrisë*, respektivisht në paragrafin 65 të tij, ndër të tjera, konstatoi se: “[...] Me fjalë të tjera, ajo u privua nga mundësia për të kundërshtuar provat në mënyrë efektive, pasi kërkesa e saj për angazhimin e një mendimi të tretë dhe vendimtar të ekspertit ishte refuzuar. [...] Edhe pse formalisht parashtruesja ishte në të njëjtin pozicion si prokuroria, kërkesa e së cilës për një mendim të tretë dhe vendimtar të ekspertit ishte refuzuar gjithashtu, Gjykata megjithatë konsideron se ndikimi i atij refuzimi cenoi ndjeshëm të drejtat e parashtrueses për mbrojtje, duke dëmtuar kështu drejtësinë e përgjithshme të gjyqimit kundër saj, në kuptim të Konventës”.
128. Në rrethanat e rastit konkret, ashtu siç është theksuar më lart, caktimi i ekspertizës nga ana e gjykatave me kërkesë të të pandehurës është e parashikuar edhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, dhe në këtë kuptim, respektimi i një kriteri të tillë procedural gjatë zhvillimit të procedurës penale ka për synim garantimin e një gjykimi të drejtë, i cili përfshin respektimin e parimit të barazisë së armëve. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se një kërkesë e tillë e vazhdueshme sikurse në rastin konkret, e parashtruar në vazhdimësi nga ana e parashtrueses së kërkesës përgjatë gjithë zhvillimit të procedurës penale, është dashur që të merret në konsideratë dhe të vlerësohet në atë mënyrë që gjykatave do t’iu mundësonte konstatimin e asaj nëse parimi i barazisë së armëve është respektuar në raport me parashtruesen e kërkesës ashtu siç kërkohet përmes parimeve dhe kriterëve mirë të vendosura në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.
129. Gjykata vlerëson se arsyetimi i gjykatave të rregullta për refuzimin e kërkesës për ekzaminim psikiatrik, specifikisht ai i Gjykatës Themelore, i vërtetuar edhe përmes Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, bazohet në atë se, në vlerësimin e tyre, parashtruesja e kërkesës nuk kishte shfaqur asnjë shenjë të jostabilitetit psiqik që do të

vënte në pikëpyetje gjendjen e saj mendore në momentin e kryerjes së veprës penale. Megjithatë, Gjykata bazuar në dosjen e rastit nuk vëren se është hartuar ndonjë raport ekspertësh me qëllim të arritjes së një vlerësimi të tillë. Gjykata vlerëson se për shkak të natyrës, rrethanave, peshës së veprës dhe efektit të rëndë në familje, gjykatat e rregullta duke mos lejuar ekzaminimin psikiatrik ashtu siç është paraparë edhe me Kodin e Procedurës Penale, kanë dështuar që t'i japin një trajtim individual kërkesës në fjalë. Në rrethanat specifike të një rasti të tillë, vlerësimi i lirë i gjykatave të rregullta se parashtruesja e kërkesës nuk ka shfaqur asnjë shenjë të jostabilitetit psikik, në fakt kërkon administrim të veçantë profesional në kuadër të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm dhe një vlerësim dhe konstatim i tillë i takon vetëm vlerësimit të një eksperti të fushës përkatëse.

130. Gjykata thekson se kërkesa e parashtrueses së kërkesës për ekzaminim psikiatrik, e parashtruar përgjatë zhvillimit të procedurës penale ndaj saj hyn në fushëveprimin e parimit të parimit të barazisë së armëve ashtu siç ka konstatuar GJEDNJ në rastin *Gaggl kundër Austrisë*. Kjo, ndër tjerash, edhe për faktin që mundësia për të aprovuar një kërkesë të tillë nga palët në procedurë është e përcaktuar edhe me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Respektimi i një garancie të tillë përgjatë zhvillimit të procedurës penale, sigurisht në ndërlidhje edhe me garancitë tjera procedurale, do të rezultonte edhe në garantimin e një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm, në kuptim të paragrafit 1 dhe 4 të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KENDJ-së.
131. Gjykata në vijim, i referohet edhe arsyetimit të dhënë nga Gjykata Themelore, në rrethanat e këtij rasti, përkatësisht: [...] *përderisa vet [parashtruesja e kërkesës] rrëfen një skenar të një ngjarje të pa qenë kinse me abuzimin e të miturit, e që vërtetë edhe Hiqkoku do ia kishte zili të njëjtës për ndërtimin e një skenari të tillë imagjinar*". Duke iu referuar gjuhës së përdorur më lart, Gjykata vëren se përderisa Gjykata Themelore kishte refuzuar kërkesën e parashtrueses së kërkesës për ekzaminim psikiatrik, e njëjta kishte marrë lirinë vetë-vlerësimit të gjendjes mendore të parashtrueses së kërkesës, duke përdorur edhe gjuhë paragjyquese siç reflekton, ndër tjerash, shembulli i gjuhës së lartcekur.
132. Gjykata vlerëson se në rrethanat specifike të këtij rasti, dhe duke marrë parasysh vet gjuhën e përdorur në arsyetimin e Gjykatës Themelore, kjo e fundit, është dashur që ta marrë në konsideratë kërkesën e parashtrueses së kërkesës për ekzaminim psikiatrik të cilën kërkesë nuk e ka aprovuar as Gjykata e Apelit dhe as ajo Supreme.
133. Në dritën e të lartcekurave, Gjykata thekson se, në kuptim të parimit të barazisë së armëve, parashtrueses së kërkesës është dashur ti jepej një mundësi e arsyeshme nga ana e gjykatave të rregullta për aprovimin e kërkesës së saj për ekzaminim psikiatrik në mënyrë që ajo të mos vendosej në pozitë të pafavorshme në raport me prokurorinë.
134. Në kontekst të këtyre rrethanave dhe bazuar në si më sipër, (i) marrë parasysh faktin se parashtruesja e kërkesës nuk e kishte kontestuar veprën penale; (ii) rrethanat specifike në të cilat kishte ndodhur ngjarja; (iii) marrëdhënien e parashtrueses së kërkesës me të ndjerin A.S.; (iv) pretendimin e saj se ajo përgjatë disa viteve kishte qenë viktimë e dhunës nga i ndjeri A.S.; dhe (v) kërkesën e saj të vazhdueshme që t'i bëhet ekzaminimi psikiatrik, Gjykata vlerëson se në rrethanat e rastit konkret aprovimi i kërkesës për ekzaminim e saj psikiatrik, përpos që do përçonte bindjen te parashtruesja e kërkesës se ajo në lidhje me kërkesën e saj është dëgjuar nga ana e gjykatave të rregullta, gjithashtu në një kontekst në të cilin e njëjta nuk ka patur mundësinë t' i ballafaqojë dëshmitarët kundër saj, do të ndikonte në një procedurë gjyqësore, e cila në tërësinë e saj, do të ishte e drejtë dhe e paanshme dhe në kontekst të parimit të barazisë së armëve.

135. Në fund, Gjykata, në kuptim të parimit të barazisë së armëve, konstaton se refuzimi i kërkesës së parashtrueses së kërkesës për ekzaminim psikiatrik, rezultoj në cenimin e e parimit të barazisë së armëve, përkatësisht të drejtën e parashtrueses së kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

(c) lidhur me pamundësinë për të paraqitur provat e propozuara nga mbrojtja

136. Përkitazi me këtë pretendim parashtruesja e kërkesës para Gjykatës thekson se: “[...] nuk i është lejuar prezantimi i provave të prezentuara nga mbrojtja e saj, që kanë të bëjnë me lëndime të shumta trupore [...] të prezentuara nga mbrojtja përmes fotografive të shumta që i janë prezentuar gjykatës por nuk janë vlerësuar fare nga gjykata por janë injoruar sikur ato të mos ekzistonin fare”. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesja e kërkesës shton se në asnjë instancë gjyqësore, nuk janë pranuar që të administrohen prova të cilat dëshmojnë se e njëjta ishte viktimë e dhunës në familje dhe të cilat sipas saj do të shkonin në favor të mbrojtjes së saj.
137. Në adresim të këtij pretendimi, Gjykata i referohet pjesës specifike të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, që ndërlidhet me pretendimin e parashtrueses së kërkesës se nuk janë administruar provat të cilat dëshmojnë se e njëjta ishte viktimë e dhunës në familje dhe të cilat i ka propozuar mbrojtja e parashtrueses së kërkesës, dhe lidhur me këtë pretendim Gjykata e Apelit shton se gjykata e shkallës së parë në këtë rast ka pasur parasysh provat materiale të propozuara nga mbrojtësja e parashtrueses së kërkesës të siguruar nga autoritetet franceze : “... mirëpo nga shkresat e lëndës dhe nga provat e tjera materiale vërtetohet se edhe provat në fjalë, gjykata e shkallës së parë i ka marrë parasysh dhe atë sidomos të dhëna përkitazi me të kaluarën e të akuzuarës dhe tani të ndjerit, në kuptim të jetës bashkëshortore, pastaj nga deklaratat e dëshmitarëve – fqinjëve të akuzuarës ka vërtetuar edhe sjelljen e të akuzuarës ndaj tani të ndjerit, sjellje këto, pra, që nuk kanë qenë të atij niveli që do të mund të konkludohej se vetëm tani i ndjeri ka pasur sjellje të dhunshme, ngase edhe për të akuzuarën dëshmitarët në fjalë kanë vërtetuar sjellje agresive të akuzuarës në raport me të ndjerin, prandaj, Gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka refuzuar për sigurimin edhe të provave tjera materiale nga shteti i Francës, përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë”.
138. Në vazhdim në adresim të këtij pretendimi, Gjykata rikujton edhe arsyetimin e Aktgjykimit [PML. nr. 310/2020] të Gjykatës Supreme, të 28 prillit 2021, përmes të cilit ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, dhe i cili arsyeton, ndër tjerash, si në vijim: “Përkitazi me shkelje të ligjit penal siç del nga përmbajtja e kërkesës, mbrojtësja pretendon se në rastin konkret është shkelur ligji penal, ngase sipas mbrojtjes së të dënuarës dhe provave materiale e dënuara ka vepruar në mbrojtje të nevojshme si pasojë e abuzimit seksual të të ndjerit me të miturin dhe keqtrajtimin apo dhunën e përdorur të të ndjerit ndaj të dënuarës natën kritike, e të cilat rrethana flasin për vrasje të kryer në mbrojtje të nevojshme nga neni 179, par. 1 pika 3 lidhur me nenin 12 par. 1 përkatësisht 4 të KPRK-së. Mirëpo, këto pretendime kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara. Së pari, në këtë çështje juridiko penale nuk rezulton kontestues fakti se raportet bashkëshortore në mes të dënuarës dhe të ndjerit nuk ishin të mira dhe se i ndjeri ka përdorur dhunë ndaj të dënuarës, por përkitazi me momentin kritik nuk ka dëshmitar okular të ngjarjes.[...] sa i përket propozimit të mbrojtësës për ekspertizën psikiatrike për të vërtetuar gjendjen psikike të të dënuarës në momentin e kryerjes së veprës penale, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar një propozim të tillë dhe në këtë drejtim ka dhënë arsye të qarta të cilat si të drejta i aprovon edhe kjo gjykatë. E dënuara fillimisht kishte jetuar me familjen e të dënuarit, pastaj kishin shkuar në Francë dhe atje një kohë kishte jetuar vetëm dhe

sipas kërkesës së saj edhe i ndjeri kishte shkuar në Francë për të jetuar me të [...] Pastaj, nga shkresat e lëndës nuk rezulton asnjë provë që e argumenton faktin se e dënuara natën kritike kishte pësuar lëndime nga i ndjeri, andaj edhe pretendimet në këtë drejtim janë të pabazuara dhe për këtë gjykatë nuk është e qartë se në çka mbrojtja e mbështet këtë pretendim. Në fakt, rezulton se gjykata ka refuzuar të administroj raportet mjekësore para ngjarjes kritike, por në shkresat e lëndës nuk ka prova që e argumentojnë faktin se e dënuara natën kritike kishte pësuar lëndime nga i ndjeri”.

139. Në këtë drejtim, Gjykata bazuar në arsyetimet e lartcekura vëren se arsyetimet e dhëna nga gjykata e rregullta ndaj pretendimeve specifike të ngritura nga ana e parashtrueses së kërkesës janë të përgjithësuara dhe nuk kanë adresuar dhe arsyetuar në mënyrë specifike pretendimet e saj në lidhje me provat, të cilat ajo në vazhdimësi i ka propozuar dhe të cilat sipas saj do të shkonin në favor të mbrojtjes, duke dëshmuar, ndër tjerash, se parashtruesja e kërkesës në vazhdimësi ishte viktimë e dhunës në familje.
140. Në vijim të kësaj, Gjykata vë në dukje se në kuptim të parimit të barazisë së armëve dhe atij të kontradiktoritetit, gjykata nuk kanë arritur që të garantojnë respektimin e këtyre parimeve, si rezultat i mosadresimit dhe arsyetimit specifik, i cili ka rezultuar në mospranimin e këtyre provave dhe të cilat në rrethanat e rastit konkret do të ishin vendimtare, jodetyrimit për përcaktimin e fajësisë së parashtrueses së kërkesës, por për sqarimin e rrethanave të rastit, motivin si dhe përcaktimin e lartësisë së dënimit përkatës. Kjo për arsye se çështja e adresimit të propozimit për administrim të provave, të propozuar nga pala mbrojtëse, duhet t'i nënshtrohet garancive të përcaktuara në kuptim të parimit të barazisë së armëve, përmes së cilës arrihet të dëshmohet që edhe pala mbrojtëse në procedurë është trajtuar në mënyrë të barabartë në raport me prokurorinë.
141. Në dritën e të lartcekurave, Gjykata vlerëson se procedura penale në tërësinë e saj nuk është zhvilluar në mënyrë të drejtë në kuptim të garancive procedurale të përcaktuara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i cenimit të parimit të barazisë së armëve, sepse në rrethanat specifike të rastit konkret, përgjatë procedurave gjyqësore, prokuroria dhe mbrojtja nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë, ndër tjerash, si rezultat i (i) pamundësisë së parashtrueses së kërkesës për t'u ballafaquar me dëshmitarët kundër saj; (ii) refuzimit për administrimin e provave dhe të cilat do të mund të dëshmonin që parashtruesja e kërkesës kishte qenë viktimë e dhunës në familje; dhe (iii) refuzimit të vazhdueshëm të kërkesës për ekzaminim psikiatrik, përkundër faktit që arsyetimi i Gjykatës Themelore reflekton gjuhë paragjyqëse ndaj parashtrueses së kërkesës në këtë kontekst.

II. Përkritazi me pretendimin e parashtrueses së kërkesës që ndërlidhet me dëshminë e dëshmitarit të mitur [X.X.]

142. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesja e kërkesës, përkritazi me këtë pretendim në kërkesën e saj, ndër tjerash, theksoi se: “[...] lidhur me mosrespektimin e të drejtës së të pandehurës për gjykim të drejtë është shkelur edhe neni 130, par. 5 i KPP-së [Kodit të Procedurës Penale], sepse me rastin e marrjes në pyetje të miturit [X.X.] si dëshmitar i vetëm okular e që ka qenë viktimë e [...] është marrë në pyetje në shqyrtim gjyqësor pa praninë e psikologut për fëmijë edhe pse i njëjti për shkak të moshës së tij dhe faktit se ka qenë viktimë [...], mirëpo gjykata është mjaftuar me konstatimin se me rastin e marrjes së tij në pyetje ka marrë pjesë një punëtor social”.
143. Gjykata, në shqyrtimin e këtij pretendimi, të ngritur në kuadër të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, fillimisht vë në pah rrethanat specifike që ndërlidhen me dëshmitarin

fëmijë X.X., i cili është i biri i parashtrueses së kërkesës dhe të ndjerit A.S. Fëmija X.X. në cilësi të dëshmitarit okular (si i vetmi dëshmitar okular i ngjarjes), dëshminë e tij para Gjykatës Themelore e kishte dhënë vetëm para “punëtorit social e jo edhe para psikologut”.

144. Parashtruesja e kërkesës pretendon se marrja e dëshmisë e të miturit X.X., pa praninë e një psikologu, marrë parasysh rrethanat dhe ndjeshmërinë e rastit konkret, përbën shkelje të garancive procedurale të përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës.
145. Në kuptim të parimeve kushtetuese dhe atyre të përcaktuara me instrumentet ndërkombëtare, Gjykata fillimisht vë në pah se trajtimi i rasteve, kur në pyetje janë fëmijët dëshmitarë/viktima që kanë përjetuar akte të dhunës në familje qoftë drejtëpërdrejtë, qoftë kur aktet e tilla janë të pranishme ndërmjet prindërve sikurse edhe në rastin e dëshmitarit X.X., autoritetet publike *ex officio* mveshen me detyrimin pozitiv për mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës dhe ofrimin e garancive kushtetuese sipas të cilave çdo fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna dhe viktimizimi. Një detyrim i tillë është i përcaktuar edhe me dispozitat kushtetuese dhe të instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.
146. Gjykata rikujton se në nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marreveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës janë të listuara marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare që kanë zbatim të drejtëpërdrejtë në Republikën e Kosovës, ndër to edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve dhe Konventa e Stambollit. Detyrimet që dalin nga këto instrumente ndërkombëtare mund të afektojnë, ndër të tjera, edhe respektimin e garancive procedurale gjatë zhvillimit të një procedure penale, siç janë rrethanat në rastin konkret.
147. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata rikujton që nga shkresat e lëndës rezultojnë që dëshmitari X.X., si njëri nga fëmijët e parashtrueses së kërkesës, i ishte ekspozuar një historie shumë të rëndë të dhunës në familje dhe ishte i vetmi dëshmitar okular i një akti shumë të rëndë familjar. I njëjti ishte i ftuar në cilësinë e dëshmitarit në seancat shqyrtuese të zhvilluara para Gjykatës Themelore. Thënë kështu, nga shkresat e lëndës rezultojnë se parashtruesja e kërkesës, përkatësisht nëna e tij, në cilësi të të akuzuarës, në seancën shqyrtuese i kishte parashtruar pyetje atij vetëm në praninë e punëtorit social.
148. Lidhur me këtë, Gjykata nga dosja e lëndës vëren rolin e Qendrës për Punë Sociale, si organ i kujdestarisë. Në rrethanat e rastit konkret, punëtori social në mungesë të të dy prindërve, në relacion me dëshmitarin X.X., ka qenë i pranishëm në kapacitetin e përfaqësuesit të autorizuar të organit të kujdestarisë. Së pari, prania e punëtorit social në mungesë të prindërve, është kriter formal të cilin është i obliguar ta zbatojë çdo autoritet publik. Nga dosja e lëndës po ashtu rezultojnë se përveç pranisë zyrtare/formale të punëtorit social, nuk ka asnjë dëshmi apo raport të vlerësimit të gjendjes psikike të fëmijës apo të ofrimit të mbështetjes profesionale/psikologjike gjatë marrjes në pyetje të tij në procedurë penale. Gjykata vlerëson se në një rast të tillë, ofrimi i mbështetjes profesionale/psikologjike është sidomos i rëndësishëm në situatat kur fëmija është pa përkujdesje prindore dhe ai ka vuajtur pasojat e dhunës në familje dhe të konfliktit familjar që kanë për epilog një akt shumë të rëndë, përkatësisht vrasjen e njërit nga prindërit e tij.
149. Gjykata thekson se në kuptim të obligimeve pozitive të përcaktuara me Kushtetutë dhe me instrumentet ndërkombëtare, përfshirë edhe praktikën relevante gjyqësore të GJEDNJ-së, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata e parë dhe më e rëndësishme për të gjitha autoritetet publike. Kjo për faktin se edhe në kuptim të administrimit të mirëfilltë të drejtësisë, interesi më i mirë i fëmijës është

obligim/detyrim parësor i të gjitha autoriteteve publike, përfshirë sistemin e drejtësisë dhe të gjithë mekanizimin e mbrojtjes dhe të mbështetjes së dëshmitarëve/viktimave të dhunës në familje.

150. Më tej, Gjykata vë në dukje se nuk mund të ketë administrim adekuat dhe vlerësim të drejtë të dëshmisë së një fëmije, dëshmitarë të vetëm okular të ngjarjes përkatëse, pa mbështetje profesionale, për qëllime të procedurës penale, në një procedurë në të cilën gjykohej çështja e vrasjes së babait të tij dhe e akuzuar ishte nëna e tij. Në këtë kuptim, Gjykata vëren një dështim të gjykatave të rregullta për trajtimin adekuat të një dëshmitari fëmijë, në një kontekst kaq specifik, si në rrethnat e rastit konkret kur dëshmitari X.X., është dëshmitarë i dhunës në familje dhe është në përkujdesje shtetërore për shkak të pamundësisë që të jetë nën përkujdesjen prindërore.
151. Në dritën e të lartcekurave dhe në kuptim të detyrimeve *ex officio* për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës në secilin rast, Gjykata, i referohet dispozitave të Kushtetutës, Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventës së Stambollit.
152. Në këtë drejtim, Gjykata së pari rikujton nenin 50 [Të Drejtat e Fëmijës] të Kushtetutës, i cili përcakton si në vijim:

1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre.
[...].
3. Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.

153. Bazuar në nenin 50 të Kushtetutës, Gjykata vë në dukje se fëmijët në procedurë gjyqësore duhet që të gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe se interesi më i lartë i tyre gjatë zhvillimit të procedurës duhet të jetë konsideratë parësore e secilit autoritet publik. Prandaj, në vijim të kësaj, Gjykata konsideron se një mbrojtje e tillë duhet që fëmijës t'i garantohet sa herë që autoritetet shtetërore të marrin një vendim në lidhje me një fëmijë ashtu siç është situata në rrethanat e rastit konkret.
154. Gjykata po ashtu i referohet edhe Konventës për të Drejtat e Fëmijës, e cila përcakton parimet dhe standardet themelore në mbrojtje të interesave më të mira të fëmijës. Më specifikisht, neni 3 i kësaj Konvente përcakton që:

1. Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të mirëqenies shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislativë, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore.
2. Shtetet palë angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ato marrin të gjitha masat legjislativë dhe administrative përkatëse.
3. Shtetet palë sigurojnë që institucionet, shërbimet dhe qendrat përgjegjëse për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe të aftësive të personelit të tyre si dhe të mbikëqyrjes së duhur.

155. Gjykata po ashtu i referohet edhe paragrafit 3 të nenit 18 të Konventës së Stambollit sipas të cilës shtetet anëtare të Konventës kanë detyrime pozitive që masat e ndërmarra nga autoritetet shtetërore "[...] të fokusohen tek të drejtat e njeriut dhe siguria e

viktimës; – të bazohen në një përjasje të integruar, e cila merr parasysh marrëdhënien midis viktimave, autorëve të veprave penale, fëmijëve dhe mjedisit të tyre më të gjerë social; – të synojnë shmangien e viktimizimit dytësor; – të synojnë fuqizimin dhe pavarësinë ekonomike të grave, viktimat të dhunës; – të lejojnë, sipas rastit, një gamë mbrojtjeje dhe shërbimesh mbështetëse që duhet të vendosen në të njëjtat ambiente; – të trajtojnë nevojat specifike të personave të pambrojtur, duke përfshirë viktimat fëmijë dhe t'u vihen në dispozicion”.

156. Gjykata, duke iu referuar obligimeve pozitive në kuadër të parimeve të përgjithshme të mbrojtjes dhe mbështetjes për fëmijët që përjetojnë dhunë në familje, përkujton se të gjithë akterët janë të obliguar të marrin parasysh: “[...] në mënyrë adekuate efektet shkatërruese të dhunës dhe kohëzgjatjen e procesit të rimëkëmbjes ose nëse trajtojnë viktimat në mënyrë të pandjeshme, rrezikojnë të riviktimizojnë përdoruesit e shërbimit.[...]” (shih Raportin Shpjegues mbi Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (11 maj 2011) paragrafin 116).
157. Përderisa në kuptim të respektimit të garancive procedurale gjatë zhvillimit të procedurës penale, Gjykata i referohet edhe paragrafit 5 të nenit 130 të KPPK-së, i cili përcakton që: *“Me rastin e marrjes në pyetje të personit i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, sidomos kur ai është dëmtuar me veprën penale veprohet me kujdes që pyetja të mos ndikojë dëmshëm në gjendjen e tij mendore”*. Bazuar në këtë dispozitë të KPPK-së, Gjykata vëren se e njëjta garanton mbrojtjen e fëmijës apo detyrimin për të pasur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës në rrethanat e marrjes në pyetje.
158. Gjykata, në vijim, rikujton se Gjykata Themelore në procedurë të administrimit të provave, dëshmisë së të miturit [X.X.] pjesërisht ia kishte falur besimin me arsyetimin se: *“[...] është e qartë se këto pohime janë bërë nën ndikimin e tani të akuzuarës [patashtruesës së kërkesës]”, duke konstatuar se pohimet e të miturit i merr për bazë vetëm në raport me raportet jo të mira dhe problemet në vazhdimësi ndërmjet parashtrueses së kërkesës dhe të ndjerit A.S., përderisa dëshminë e tij për ngjarjen që i kishte paraprirë momentit kritik nuk ia falë besimin, duke e cilësuar të njëjtën kontradiktore dhe në funksion të alibisë së mbrojtjes së parashtrueses së kërkesës, përkatësisht nënës së tij.*
159. Më tej, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar në Gjykatën Supreme, kishte ngritur çështjen e dhënies së dëshmisë nga X.X. Në adresimin e këtij pretendimi, Gjykata Supreme arsyetoi se: *“[...] nuk është shkelur as dispozita e nenit 130, paragrafi 5 të KPPK-së. Në fakt, sipas kësaj dispozite me rastin e marrjes në pyetje të personit i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, sidomos kur ai është i dëmtuar me veprën penale veprohet me kujdes që pyetja të mos ndikojë dëmshëm në gjendjen e tij mendore. Kur është e nevojshme ai pyetet me ndihmën e psikologut për fëmijë, ose pedagogut për fëmijë, ose ekspertit tjetër që është profesional. Pra, nga kjo dispozitë del se marrja në pyetje nëpërmjet psikologut nuk është detyrim i gjykatës por në rast se gjykata e sheh të nevojshme, pra është në diskrecon të gjykatës të vlerësoj se duhet të dëgjohet personi që nuk ka mbushur 18 vjet nëpërmjet psikologut apo personave të tjerë profesional. Në rastin konkret, Gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme, por X.X. është marrë në pyetje në prezencë të përfaqësuesit të punëtorit social dhe ka vepruar me kujdes të posaçëm sepse siç del nga shkresat e lëndës mbrojtësi të gjitha pyetjet ai ka parashtruar nëpërmjet të dënuarës”*.

160. Gjykata, rikujton se është në kompetencën e gjykatave të rregullta të vendosin se a do t'ia falin besimin dëshmisë të dëshmitarit X.X. apo jo. Megjithatë, në kuadër të obligimeve të lartcekura pozitive për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës, obligim i cili është mishëruar edhe në vetë dispozitat e procedurës penale, mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore, sidomos në kontekst të situatës familjare të dëshmitarit X.X., të gjendjes faktike që ka të bëjë me dëshminë për aktin penal dhe efektit emocional dhe psikologjik për fëmijën/dëshmitarin në rrethanat specifike të rastit konkret.
161. Në dritën e dispozitave të lartpërmendura, Gjykata i referohet edhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përmes të cilës është theksuar se procedurat penale që ndërliken me fëmijët duhet të organizohen në mënyrë të atillë që të respektojë parimin e interesit më të lartë të fëmijës (shih, rastet e GJEDNJ-së [*Adamkiewicz kundër Polonisë*](#), nr. 54729/00, Aktgjykim i 2 marsit 2010, paragrafi 20; [*Panovits k. Qipros*](#), nr. 4268/04, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2008, paragrafi 67; dhe [*V. kundër Mbretërisë së Bashkuar*](#) [DHM], nr. 24888/94, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1999, paragrafi 86). Në mbështetje të kësaj edhe GJEDNJ thekson se: *“Në raste kur fëmijët janë pjesë e procedurës dhe përballen në marrjen e vendimeve në një fushë kaq të ndjeshme, autoritetet vendore dhe gjykatat përballen me një detyrë jashtëzakonisht të vështirë”*.
162. Gjykata rithekson obligimin e të gjitha autoriteteve publike dhe private për të respektuar të drejtën që: *“Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna”*. Ky obligim është i zbatueshëm edhe në sistemin e drejtësisë, në çdo procedurë, përfshirë edhe procedurat penale kur të miturit janë pjesë e procesit gjyqësor, si në rastin konkret të X.X. në cilësinë e dëshmitarit, në një situatë të ndërlikuar penale dhe me histori të dhunës në familje.
163. Thënë këtë, Gjykata vë në pah se përtej standardit të përcaktuar me nenin 50 të Kushtetutës, nenin 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, nenin 18 të Konventës së Stambollit, praktikës së lartcekur gjyqësore të GJEDNJ-së, mundësia e ndihmës së psikologut gjatë zhvillimit të procesit penal është e garantuar edhe me dispozitat e KPPK-së. Gjykata vlerëson se vet përmbajtja e paragrafit 5 të nenit 130 të KPPK-së në kuptim të detyrimit për të garantuar interesin më të lartë të fëmijës gjatë procedurës së marrjes në pyetje të tij, në mënyrë të qartë përcakton që i njëjti merret në pyetje me ndihmën e psikologut ose të ekspertit adekuat. Nga kjo rezulton që në procedurë të marrjes në pyetje të fëmijës, me theks në një procedurë penale që ngërthen specifikat siç janë rrethanat e rastit konkret, interesi më i lartë i fëmijës duhet të garantohet me prezencën e një profesionisti i cili gjatë kësaj procedure kujdeset që të mos i cenohet mirëqenia dhe dinjiteti i fëmijës.
164. Prandaj, Gjykata konsideron se bazuar në përcaktimin e nenit 50 të Kushtetutës dhe nenin 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës si dhe nenit 18 të Konventës së Stambollit, konsiderata për interesin më të lartë të fëmijës, në mënyrë të drejtpërdrejtë krijon detyrim për autoritetet shtetërore për respektimin e drejtës së fëmijës për mbrojtje nga dhuna, dhe një detyrim i tillë duhet të gjejë zbatim edhe në procedurë gjyqësore, gjatë së cilës fëmija mund të jetë edhe në cilësinë e dëshmitarit.
165. Prandaj, në aplikimin e parimeve të lartcekura të përcaktuara me Kushtetutë; Konventën për të Drejtat e Fëmijës; Konventën e Stambollit; praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së si dhe kërkesat e përcaktuara me paragrafin 5 të nenit 130 të KPPK-së, e që në rrethanat e rastit konkret ndërliken me detyrimin për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës në procedurë penale, Gjykata vëren se fëmija X.X., gjatë dhënies së dëshmisë apo marrjes në pyetje, nga parashtruesja e kërkesës, përkundër ndjeshmërisë që e karakterizonte rastin dhe faktin se vet ai kishte qenë viktimë e raporteve shumë të

rënduara familjare, nuk i është ofruar ndihmë dhe mbështetje përmes ekspertit përkatës të fushës.

166. Prandaj, marrë për bazë ndjeshmërinë e ngjarjes dhe faktin se fëmija në procedurë penale ka dëshmuar për raportet e prindërve, si i vetmi dëshmitar okular i ngjarjes dhe natyrën e dëshmisë së tij, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë cenuar parimin e mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, i cili ka rezultuar në cenim të garancive kushtetuese që një fëmijë të jetë i mbrojtur nga efektet e dhunës, e sidomos efektet shkatërruese të dhunës në familje, duke mos i ofruar mbështetje profesionale gjatë marrjes në pyetje në procedurë penale.
167. Si rezultat i kësaj, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë dështuar në përmbushjen e detyrimit të lartcekur për mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës. Thënë këtë, Gjykata konsideron se trajtimi i duhur i dëshmitarit të mitur në procedurë gjyqësore është edhe pjesë përbërëse e procesit të rimëkëmbjes së viktimave të dhunës në familje. Prandaj, marrja në pyetje e dëshmitarit X.X., pa mbështetje adekuatë dhe psikologjike ka rrezikuar edhe riviktimizimin e tij gjatë zhvillimit të procedurës penale. Në këtë kuptim, Gjykata konsideron se një detyrimi të tillë në rradhë të parë është i aspektit përmbajtësor, i cili në rast të mospërmbushjes mund të rezultojë apo të afektojë edhe cenimin e garancive procedurale gjatë zhvillimit të procedurës penale.
168. Në dritën e këtyre konstatimeve, Gjykata konkludon se procedura e marrjes në pyetje të X.X., e zhvilluar nga Gjykata Themelore, e vërtetuar nga Gjykata e Apelit dhe më pas edhe nga Gjykata Supreme, është zhvilluar në kundërshtim me garancitë e përcaktuara me nenin 50 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe paragrafin 3 të nenit 18 të Konventës së Stambollit dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe se cenimi i këtyre detyrimeve pozitive të aspektit përmbajtësor kanë rezultuar edhe në shkleje të garancive procedurale gjatë zhvillimit të marrjes në pyetje dhe administrimit të kësaj dëshmie nga ana e gjykatave të rregullta, në kuptim të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

III. Përkitazi me pretendimet tjera të parashtrueses së kërkesës

169. Gjykata gjithashtu rikujton se parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon se aktgjykimet e instancave më të ulëta janë bazuar në prova, të cilat sipas saj, nuk i përmbushin standardet e përcaktuara me ligj për t'u konsideruar si prova.
170. Gjykata në këtë pikë rikujton arsyetimin e Aktgjykimit [PAKR. nr. 133/2020] të Gjykatës së Apelit e cila në adresimin e këtij pretendimi shton se të gjitha provat të cilat janë siguruar nga Shteti i Francës, janë proceduar konform dispozitave ligjore të këtij të fundit, *"... që do të thotë se sipas dispozitave të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar të Kosovës, të gjitha provat që sigurohen nga Shteti tjetër duhet të jenë të proceduara konform dispozitave të atij shteti, gjë që edhe ka ndodhur në rastin konkret"*.
171. Më tutje, Gjykata citon Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, ku në ndërlidhje me këtë pretendim shtohet se *"...janë të pabazuar pretendimet se këto prova nuk janë siguruar në mënyrë të ligjshme, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se provat e siguruar nga autoritetet Franceze janë marrë konform dispozitave të kodit të procedurës penale të Francës dhe si të tilla edhe i janë dorëzuar autoriteteve vendore. Në fakt, mbrojtësja vetëm citon dispozitat ligjore të kodit të procedurës penale (neni 209 par. 6 të KPPK-së) por nuk e konkretizon faktin se në çka konsiston kundërligjshmëria e tyre, e përveç*

kësaj ato nuk janë prova e vetme apo vendimtare për gjetjen e fajësisë siç u tha edhe më lart, ngase e dënuara e ka pranuar faktin se e ka kryer vrasjen por nën pretekstin se ka qenë e sulmuar [...]”.

172. Në këtë pikë Gjykata rikujton edhe dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në çështje penale, respektivisht paragrafin 1 të nenit 80 i cili parasheh:

Me kërkesën e organit gjyqësor të shtetit tjetër organet gjyqësore vendore ofrojnë ndihmë në lidhje me procedurat penale për vepra penale ndjekja e të cilave në kohën e kërkesës për ndihmë bie brenda juridiksionit të organeve gjyqësore të shtetit kërkuar.

[...]

4. Organet gjyqësore vendore i japin përparësi ekzekutimit të kërkesave për ndihmë juridike të ndërsjellë dhe marrin në konsideratë afatet procedurale dhe kushtet tjera të përmendura shprehimisht nga shteti kërkuar.

173. Tutje, nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se në rastin konkret ishin lëshuar dy urdhërarreste ndërkombëtare, respektivisht Mandat-Arresti Ndërkombëtar dhe Mandat-Arresti Evropian të lëshuara nga autoritetet franceze.
174. Në kuptim të kësaj, Gjykata edhe një herë rikujton se parashtruesja e kërkesës asnjëherë nuk e ka kontestuar kryerjen e veprës penale dhe pasi që Gjykata tashmë ka konstatuar shkelje të parimit të barazisë së armëve në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, duke e kthyer këtë çështje penale në rigjykim, nuk do të lëshohet më tej në vlerësimin e këtij pretendimi të parashtrueses së kërkesës.

Përfundime

175. Përfundimisht dhe në kontest të rrethanave të veçanta të procedurës penale në rastin e parashtrueses së kërkesës, procedurë kjo që ka përfunduar përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, Gjykata, konstaton se, kombinimi i rrethanave si në vijim, përkatësisht (i) refuzimi i kërkesës së parashtrueses së kërkesës për t'i ballafaquar dëshmitarët; (ii) refuzimi i kërkesës së saj për ekzaminim psikiatrik; (iii) refuzimi dhe mosarsyetimi i administrimit të provave përkatësisht, dëshmi të propozuara nga pala mbrojtëse dhe sipas të cilave, ndër tjerash, rezultojnë që parashtruesja e kërkesës ishte viktimë e dhunës në familje; dhe (iv) mungesa e mbështetjes profesionale për të miturin e përfshirë në procedurë dhe i cili ishte edhe dëshmitari i vetëm okular në këtë procedurë penale, kanë rezultuar në trajtim të pabarabartë në mes prokurorisë dhe mbrojtjes, duke rezultuar kështu në cenimin e parimit të barazisë së armëve, kanë rezultuar në cenimin e garancive procedurale të mishëruara në paragrafin 1 dhe 4 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me pikën d) të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së.
176. Gjykata gjithashtu rithekson që procedura e marrjes në pyetje të fëmijës në kuadër të procedurës penale, është zhvilluar në kundërshtim me detyrimet dhe garancitë e përcaktuara me paragrafin 3 të nenit 50 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, paragrafit 3 të nenit 18 të Konventës Konventës së Stambollit dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Rrjedhimisht, cenimi i këtyre detyrimeve pozitive të aspektit përmbajtësor kanë rezultuar edhe në shkelje të garancive procedurale gjatë zhvillimit të marrjes në pyetje dhe administrimit të kësaj dëshmie nga ana e gjykatave të rregullta, në kuptim të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

177. Gjykata thekson se përkundër gjetjeve të këtij Aktgjykimi, efektet e tij në raport me dëshmitarin X.X. janë të natyrës parimore. Thënë këtë, Gjykata vlerëson se është shumë e rëndësishme që të vendoset standard në praktikën gjyqësore në Republikën e Kosovës në kuptim të mbrojtjes së fëmijëve viktimë/dëshmitarë të dhunës në familje. Gjykatat e rregullta, në të ardhmen do të duhet të veprojnë në përputhje me parimet dhe standardet e mishëruara në dispozitat kushtetuese, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventës për të Drejtat e Fëmijës, Konventës së Stambollit dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Në këtë kontekst, duke pranuar se fëmijët janë viktimë të dhunës në familje, përfshirë rastet si dëshmitarë të dhunës në familje, duke respektuar parimin e pavarësisë së gjykatave të rregullta, Gjykata rithekson rëndësinë e shmangies nga riviktimizimi i dëshmitarit X.X., në procedurë të rigjykitimit.
178. Në fund, Gjykata vë theks në faktin që efektet e këtij Aktgjykimi ndërlidhen vetëm me konstatimet në kuptim të garancive procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me cenimin e parimit të barazisë së armëve në kontekst të procedurës së zhvilluar penale. Gjykata, në asnjë mënyrë nuk paragjykon fajësinë apo rrjedhën e procedurës penale në rivendosje. Gjykata po ashtu thekson se mënyra e trajtimit të aktakuzës së ngritur kundër parashtrueses së kërkesës lidhur me veprën penale të vrasjes së rëndë për të cilën e njëjta akuzohet, përfshirë edhe vendimmarrjen përkatëse përkitazi me zgjatjen e paraburgimit, është në kompetencë të plotë të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ashtu sië është përcaktuar përmes dispozitave përkatëse të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Moszbulimi i identitetit

179. Në fund, Gjykata vë në pah se parashtruesja e kërkesës nuk ka parashtruar kërkesë për moszbulim të identitetit të saj ose birit të saj. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata i referohet rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili përcakton që: *"[...] Gjykata me shumicë votash autorizon moszbulimin e identitetit ose e jep atë pa një kërkesë nga një palë. Kur lejohet moszbulimi i identitetit nga Gjykata, pala duhet të identifikohet vetëm me initiale ose me shkurtesa apo me një shkronjë të vetme"*.
180. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 8 (1) të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, që përcakton:
- "Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme"*.
181. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në shkresat e lëndës si dhe duke marrë për bazë ndjeshmërinë e rastit, vlerëson që me qëllim të mbrojtjes së identitetit të fëmijës së mitur në cilësi të dëshmitarit, moszbulimi i identitetit të tij konsiderohet të jetë i domosdoshëm. Rrjedhimisht, Gjykata, identitetit të fëmijës së mitur në cilësi të dëshmitarit në këtë Aktgjykim i është referuar si X.X.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 59 (2) të Rregullores së punës, më 6 korrik 2023, me shumicë

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se Aktgjykimi [Pml. nr. 310/2020] i 28 prillit 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës; Aktgjykimi [PAKR. nr. 133/2020] i 3 korrikut 2020 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimi [PKR. nr. 37/2019] i 24 janarit 2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë nuk janë në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 4 të nenit 31 të Kushtetutës dhe pikën (d) të paragrafit 3 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË SHPALLË TË PAVLEFSHËM Aktgjykimin [Pml. nr. 310/2020] e 28 prillit 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës; Aktgjykimin [PAKR. nr. 133/2020] e 3 korrikut 2020 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [PKR. nr. 37/2019] e 24 janarit 2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- IV. TË KTHEJË çështjen në rivendosje në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në përputhje me konstatimet e këtij Aktgjykimi;
- V. TË URDHËROJË Gjykatën Themelore në Prishtinë që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, deri më 29 shkurt 2024, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës;
- VI. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VII. TË KONSTATOJË që Aktgjykimi hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese


Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani